



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 26

Tiranë – E hënë, 20 shkurt 2017

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 6/2017 datë 2.2.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar..... 1891
Ligj nr. 7/2017 datë 2.2.2017	Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme..... 1896
Ligj nr. 9/2017 datë 2.2.2017	Për një ndryshim në ligjin nr. 9288, datë 7.10.2004, “Për ratifikimin e konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”” ..... 1906
Ligj nr. 10/2017 datë 2.2.2017	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për masat e shteteve portuale për të parandaluar, frenuar dhe eliminuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar..... 1906
Ligj nr. 11/2017 datë 2.2.2017	Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e Drejtësisë së BE-së..... 1922
Vendim i Kuvendit nr 12/2017, datë 9.2.2017	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore..... 1925
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 2, datë 8.2.2017	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 18, datë 11.8.2016, “Për procedurat e aplikimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me orgjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatëve me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe egjiptianët në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016–2017” ..... 1925



**LIGJ**  
**Nr. 6/2017**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË LIGJIN NR. 7746, DATË 28.7.1993, “PËR  
HIDROKARBURET (KËRKIMI DHE  
PRODHIMI)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

**Përkufizime**

1. “Albpetrol” është një shoqëri tregtare, që zotëron të drejta kërkimi, prodhimi dhe tregtimi të hidrokarbureve në Shqipëri.

2. “E drejta e ofertës së parë” është e drejta e shoqërisë “Albpetrol” për të vazhduar operacionet hidrokarbure në zonat ku veprojnë shoqëritë e treta, me të cilat shoqëria “Albpetrol” ka lidhur marrëveshje hidrokarbure. Nëse në këto zona marrëveshjet përfundojnë përpara afatit të parashikuar në këto të fundit, termat dhe kushtet e këtyre marrëveshjeve hidrokarbure mbeten të pandryshuara.

3. “Gaz natyror” është gazi metan, përfshirë gazin shoqëruar, si dhe të gjitha hidrokarburet që janë në gjendje të gaztë, në kushte atmosferike normale, i cili përfshin edhe GNL-në, biogazin ose lloje të tjera gazi, që transmetohen dhe shpërndahen në sistemin e tubacioneve.

4. “Hidrokarbure” janë naftë bruto dhe/ose gaz natyror, si dhe ato substanca që prodhohen bashkë me to.

5. “Kërkim” është kërkimi për hidrokarbure me mjete gjeologjike, gjeofizike e të tjera dhe që përfshin shpimin e puseve të kërkimit dhe të vlerësimit.

6. “Kontraktor” është çdo person apo persona, me të cilët ministria hyn në marrëveshje hidrokarburesh dhe që mund të përfshijë edhe Albpetrolin apo çdo agjenci tjetër shtetërore.

7. “Kosto hidrokarbure” janë kostot dhe shpenzimet e kryera nga kontraktori, në lidhje me kryerjen e operacioneve hidrokarbure, siç përcaktohen në marrëveshje hidrokarbure.

8. “Licencë marrëveshje” është dhënia e autorizimit nga ministria për “Albpetrol” sh.a., sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në të, për të kërkuar, zhvilluar e prodhuar hidrokarbure në zonën e kontratës, përfshirë mundësinë e dhënies së të drejtës nga ministria për “Albpetrol” sh.a., për të transferuar dhe kaluar të gjitha ose ndonjë pjesë të të drejtave, titullimit dhe të interesit të tij një personi juridik, vendas apo të huaj, ose institucionit ndërkombëtar financiar, me të cilin ai dëshiron të bashkëpunojë, për qëllimet e përmendura në “Marrëveshjen Albpetrol”.

9. “Marrëveshja Albpetrol” është marrëveshja e lidhur më 26 korrik 1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe Albpetrolit, Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe Gazit, me të gjitha ndryshimet e saj dhe që do të vazhdojë të mbajë karakteristikat e një marrëveshjeje hidrokarbure të llojit të veçantë.

10. “Marrëveshje hidrokarburesh” është një marrëveshje e lidhur nga ministria, në përputhje me pikën 1, të nenit 5, të këtij ligji, që autorizon kontraktorin të kryejë operacione në zonën e kontratës dhe mund të marrë formën e një “Marrëveshjeje me ndarje prodhimi” ose ndonjë formë tjetër, të rënë dakord ndërmjet ministrisë dhe kontraktorit, e cila nuk është në kundërshtim me këtë ligj.

11. “Marrëveshje me ndarje prodhimi” është një marrëveshje hidrokarbure, e cila parashikon ndarjen ndërmjet shtetit dhe kontraktorit të sasisë së hidrokarbureve të mbetura, pas pagimit të rentës minerare, sipas legjislacionit fiskal në fuqi, dhe mbulimit të kostove hidrokarbure nga hidrokarburet e prodhuara në zonën e kontratës, sikurse përcaktohet në marrëveshjen hidrokarbure.

12. “Ministri” është ministri përgjegjës për veprimtarinë hidrokarbure.

13. “Ministria” është ministria përgjegjëse për veprimtarinë hidrokarbure.



14. “Naftë bruto” janë naftë, asfalte, ozokerite dhe të gjitha llojet e hidrokarbureve e bitumeve, të ngurta dhe të lëngëta, në gjendjen e tyre natyrore ose të fituara nga gazi natyror nëpërmjet kondensimit apo nxjerrjes, por që nuk përfshin qymyrguri apo ndonjë substancë tjetër që mund të nxirret nga qymyrguri.

15. “Operacione hidrokarbure” janë të gjitha ose çdo operacion që lidhet me kërkimin, vlerësimin e një zbulimi, zhvillimin, nxjerrjen, prodhimin, ndarjen e trajtimin, grumbullimin, transportimin dhe shitjen ose disponimin e hidrokarbureve deri në pikën e eksportit ose në një pikë livrimi në Shqipëri, për të cilën është rënë dakord, ose në pikën e hyrjes në një rafineri dhe përfshin operacionet e përpunimit të gazit natyror, por nuk përfshin operacionet e përpunimit të hidrokarbureve.

16. “Periudhë kërkimi” është periudha gjatë së cilës në një zonë të caktuar, në kuadër të marrëveshjeve hidrokarbure, realizohen operacione për kërkimin e hidrokarbureve.

17. “Periudhë vlerësimi” është periudha gjatë së cilës kryhen punime të domosdoshme për të përcaktuar nëse një zbulim ekzistues është zbulim komercial. Në rast të një zbulimi komercial, kjo periudhë zgjat deri në fillimin e periudhës së zhvillimit dhe të prodhimit.

18. “Person” është një person juridik.

19. “Plan zhvillimi” është një plan për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve të zbuluara në një zonë kontrate, i përgatitur në përputhje me kërkesat e nenit 6, të këtij ligji, dhe me dispozitat përkatëse të marrëveshjes së hidrokarbureve për këtë zonë kontrate.

20. “Plani i vlerësimit të një zbulimi” është një plan për përcaktimin e parametrave të hidrokarbureve dhe të rezervuarit të zbuluar, i përgatitur në përputhje me kërkesat e nenit 6, të këtij ligji, dhe me dispozitat përkatëse të marrëveshjes së hidrokarbureve për këtë zonë kontrate.

21. “Prodhim” është procesi i nxjerrjes në sipërfaqe të hidrokarbureve, nëpërmjet rrjedhjes natyrale ose nëpërmjet regjimeve artificiale të shfrytëzimit të pusit.

22. “Pus kërkimi” është çdo pus i shpuar, me qëllim vërtetimin e ekzistencës, të vendndodhjes dhe të formës së rezervuarit hidrokarbur, të sasisë dhe të cilësisë së hidrokarbureve, si dhe kushteve të prodhimit.

23. “Pus vlerësimi” është çdo pus i shpuar brenda zonës së vlerësimit, që pason një zbulim, me qëllim marrjen e informacioneve të mëtejshme për përcaktimin e parametrave të rezervuarit dhe të sasisë e cilësisë së hidrokarbureve të zbuluara.

24. “Rentë minerare” është taksa që paguhet për mineralet që nxirren nga mbitoka e nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë dhe nënprodukteve të prodhuara nga këto minerale.

25. “Rezerva” është sasia e hidrokarbureve që ka qenë zbuluar dhe që mund të nxirret në mënyrë të leverdishme me teknologjinë ekzistuese, në rrethanat dhe në kushtet ekonomike.

26. “Rezervuar” është një grumbullim natyror hidrokarburesh, që mund t’i japë ato në kushte të caktuara dhe që, zakonisht, karakterizohet nga një sistem hidrodinamik, i vendosur brenda kufijve të një strukture.

27. “Standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në industrinë e hidrokarbureve” janë praktikat dhe procedurat e përdorura ndërkombëtarisht nga operatorët, sipas rrethanave dhe kushteve të njëjta të këtyre operacioneve në industrinë e naftës, brenda zonës së marrëveshjes hidrokarbure, me qëllim që:

i) të ruajnë hidrokarburet, duke rritur prodhimin në mënyrë të qëndrueshme teknike dhe ekonomike, me një kontroll korrespondues të zvogëlimit të rezervave dhe të minimizimit të humbjeve në sipërfaqe;

ii) të promovojnë ruajtjen operacionale dhe parandalimin e aksidenteve;

iii) të ruajnë ambientin, duke synuar shmangien e impakteve të operacioneve hidrokarbure në të.

28. “Vlerësim i një zbulimi” janë të gjitha punimet e kryera nga kontraktori, në rastin e zbulimit të hidrokarbureve, me qëllim përcaktimin e përhapjes vertikale e horizontale të rezervuarit apo rezervuarëve naftë-gazmbajtës, që ka lidhje me këtë zbulim, parametrave të tij, si dhe llojin e karakteristikat e fluideve që ndodhen në të, me qëllim llogaritjen e rezervave të nxjerrshme, si dhe aktivitetet që lidhen me to, përfshirë edhe përcaktimin e leverdisë ekonomike të shfrytëzimit të tij.

29. “Zbulim” është një zbulim i hidrokarbureve, i hasur në pusin e parë të shpuar në një strukturë, e cila nuk ishte e njohur përpara shpimit, që mund të



nxirret në sipërfaqe me një debit të matshëm nga njësi matëse konvencionale të testimi të industrisë së hidrokarbureve.

30. “Zbulim tregtar” është zbulimi i një grumbullimi hidrokarburesh, i cili, në kohën kur vlerësohet, mund të shfrytëzohet ekonomikisht, në përputhje me një marrëveshje hidrokarbure.

31. “Zonë kontrate” është zona, e shtrirë dhe e kufizuar, përkatësisht, në aksin vertikal dhe akset horizontale, brenda së cilës kontraktori autorizohet të kërkojë, të zhvillojë e të prodhojë hidrokarbure, sipas një marrëveshjeje hidrokarburesh.

32. “Zonë vlerësimi” është zona e përcaktuar nga kontraktori, brenda së cilës besohet se shtrihet struktura e zbuluar, e cila kërkohet të vlerësohet.

33. “Zonë zbulimi” janë një zonë ose zonat, të përcaktuara nga kontraktori, të cilat i njoftohen me shkrim ministrisë, e shoqëruar me një hartë që tregon vendosjen e kufijve të një zone që përbën një pjesë ose të gjithë zonën e kontratës, ku kontraktori beson se përfshihet një apo më shumë zbulime. Me përcaktimin e saj, një zonë zbulimi do të shtrihet në të gjitha thellësitë brenda kufijve të saj anësorë, sikurse do të përcaktohet në një marrëveshje të përbashkët të kontraktorit dhe ministrisë apo të autorizuarit të tij.

34. “Zonë zhvillimi dhe prodhimi” janë zona ose zonat e përcaktuara prej kontraktorit, në çdo rast, përpara përfundimit të periudhës së kërkim-vlerësimit, për të cilën kontraktori njofton me shkrim ministrinë, kur ka bërë një zbulim, e shoqëruar me një hartë që përshkruan një zonë, e cila përfshin të gjithë ose një pjesë të zonës së zbulimit, që kontraktori beson se përmban zbulimin tregtar. Me përcaktimin e saj, zona e zhvillimit dhe e prodhimit do të shtrihet disa metra poshtë kontaktit naftë-ujë, në të gjitha thellësitë brenda kufijve të saj anësorë, sikurse do të përcaktohet në një marrëveshje të përbashkët të kontraktorit dhe ministrisë apo të autorizuarit të tij, me miratimin e planit/programit të zhvillimit për zonën e zhvillimit dhe të prodhimit. Zonë zhvillimi dhe prodhimi, në vendburimet ekzistuese, është sipërfaqja, sikurse përcaktohet në planin e zhvillimit ose në një plan zhvillimi të rishikuar, e përcaktuar si e tillë nga kontraktori dhe në të cilën do të zhvillohen operacione hidrokarbure gjatë periudhës së zhvillimit e të prodhimit.

35. “Zhvillim” është ndërtimi dhe instalimi i pajisjeve për prodhimin e hidrokarbureve dhe

shpimi i puseve të shfrytëzimit, në zbatim të marrëveshjes hidrokarbure përkatëse dhe në përputhje me një plan zhvillimi të miratuar.”.

## Neni 2

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ministria lidh marrëveshje hidrokarbure apo autorizon Albpetrolin, nëpërmjet një licence për lidhjen e një marrëveshjeje hidrokarbure, me një person, në qoftë se vlerëson se personi ka burimet financiare dhe kompetencën teknike të kërkuar për të përmbushur detyrimet e kontraktorit nën marrëveshjen hidrokarbure.

Ministria, për shkak të sigurisë kombëtare, mund të refuzojë lidhjen apo transferimin e kuotave të marrëveshjes hidrokarbure.

Procedurat për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve bëhen me:

a) iniciativë të ministrisë, nëpërmjet një njoftimi për të ftuar subjektet e interesuara për pjesëmarrje me anën e aplikimeve;

b) njoftim të ministrisë për të ftuar subjekte të tjera për aplikime, pas dorëzimit të kërkesës nga një subjekt për një bllok/blloqe apo vendburim/e të caktuar/a.”.

2. Në pikën 3, shkronja “a”, nën-pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Të drejtën ekskluzive për të kryer kërkimin brenda zonës së kontratës, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet, përveçse kur kontraktori jep argumente bindëse për ministrinë se ekzistojnë kushte specifike, të cilat kërkojnë një periudhë më të gjatë. Në këtë rast, kontraktori mund t’i jepet një periudhë jo më shumë se 7 vjet gjithsej. Periudha e kërkimit zgjatet me periudhën e kohës së nevojshme për të lejuar përfundimin e shpimit apo të testimi të një pusi.

Kur kontraktori bën një zbulim, me qëllim vlerësimin e tij, mund të kërkojë në ministri zgjatjen e periudhës së kërkimit deri në 3 vjet, në përputhje me planin e vlerësimit të zbulimit.”.

3. Në pikën 3, shkronja “a”, në fund të nënpikës 2 shtohen fjalët “por, në çdo rast, jo më shumë se 5 vjet”.

4. Në pikën 3, shkronja “d”, ndryshohet si më poshtë:



“d) Një marrëveshje hidrokarbure mund të përmbajë klauzola lidhur me stabilitetin e regjimit fiskal, sipas kushteve të mëposhtme:

1) Këto klauzola, sipas rastit, nuk mund të tejkalojnë një afat prej 12 vitesh, nga data e fillimit të prodhimit.

2) Përjashtohen nga regjimi i stabilitetit ligjet dhe rregulloret që lidhen me sigurinë kombëtare, marrëdhëniet e punës, mbrojtjen e natyrës dhe të mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut, traktatet ndërkombëtare, në të cilat është anëtare Republika e Shqipërisë.

3) Klauzola e stabilitetit të regjimit fiskal, sipas këtij ligji, nuk ndikon në llogaritjen dhe pagimin e detyrimeve tatimore të aplikueshme nga kontraktorët, sipas legjislacionit tatimor në fuqi.”.

#### Neni 3

Në nenin 6, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1) për të përgatitur dhe për të paraqitur në ministri për miratim planin e vlerësimit të zbulimit.”.

#### Neni 4

Në nenin 8, pika 2, fjalët “Vetëm në qoftë se nuk është paraqitur ndryshe në lejen e vlerësimit, kjo leje”, zëvendësohen me fjalët “Përveç sa parashikohet në pikën 1, të këtij neni, leja e vlerësimit.”.

#### Neni 5

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 10

#### **Marrëdhëniet e pronësisë**

1. Në rast se për zbatimin e një marrëveshjeje hidrokarbure është nevojta e përdorimit të pasurisë së paluajtshme, në pronësi private, marrëdhëniet e pronësisë që shoqërojnë një pasuri të tillë duhet të zgjidhen sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të mos pengohet realizimi i marrëveshjes gjatë periudhës kontraktore.

2. Nëse Republika e Shqipërisë është pronare e pasurisë së paluajtshme, të përfshirë në zonën e një marrëveshjeje hidrokarbure, që konsiderohet e nevojshme për realizimin e marrëveshjes hidrokarbure, atëherë palët e kontratës zgjidhin të gjitha marrëdhëniet e pronësisë, në përputhje me

legjislacionin në fuqi, në një mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar.

3. Marrëveshja hidrokarbure përcakton afatet dhe procedurat e dorëzimit ministrisë, nga kontraktori, të objekteve dhe aseteve të krijuara nga zbatimi i marrëveshjeve hidrokarbure.”.

#### Neni 6

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, në fund të shkronjës “c” shtohen fjalët “e cila do të nënshkruhet nga administratori i shoqërisë “Albpetrol” sh.a., dhe hyn në fuqi pas miratimit në Këshillin e Ministrave, me propozimin e ministrit”.

2. Në pikën 2, në fund të shkronjës “ç” shtohet fjalia “Tregtimi i gazit natyror bëhet në përputhje me legjislacionin për sektorin e gazit natyror”.

3. Në pikën 3, në fund të paragrafit të dytë shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“Ndarja e prodhimit, e parashikuar në marrëveshjet hidrokarbure, të lidhura ndërmjet shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe shoqërive të treta të kërkimit dhe prodhimit të naftës e të gazit, kryhet ndërmjet shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe shoqërisë përkatëse, në respektim të parashikimeve të këtyre marrëveshjeve.”.

#### Neni 7

Pas nenit 13 shtohen nenet 13/1, 13/2, 13/3, 13/4, 13/5 dhe 13/6 me këtë përmbajtje:

#### “Neni 13/1

#### **Instituti Shkencor i Hidrokarbureve**

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, krijon Institutin Shkencor të Hidrokarbureve, si institucion në varësi të ministrit, dhe përcakton mënyrën e organizimit, të financimit dhe të funksionimit të tij.

2. Instituti Shkencor i Hidrokarbureve është institucion këshillimor për të gjitha problemet shkencore në fushën e hidrokarbureve, me detyrë kryerjen e studimeve, të analizave, të konsulencës dhe të materialeve opONENTE, të monitorimit, në interes të organeve dhe të institucioneve shtetërore gjatë kryerjes së operacioneve hidrokarbure për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në territorin shqiptar, si dhe në sektorët e përpunimit, transportimit, depozitimit e tregimit të lëndëve e produkteve hidrokarbure.



3. Instituti Shkencor i Hidrokarbureve realizon detyra shkencore në zhvillimin e shkencës së gjeologjisë, të gjeofizikës, të teknologjisë së nxjerrjes së naftës, të shpimit të puseve, të inxhinierisë së rezervuarit, si dhe të shkencave të përafërta me to, duke realizuar edhe kualifikimin e personelit të tij, në bashkëpunim me strukturat universitare.

4. Për të realizuar funksionin dhe detyrat e përcaktuara në këtë ligj, Instituti Shkencor i Hidrokarbureve administron dhe përpunon, sipas teknikave e standardeve ndërkombëtare, të dhënat gjeologo-gjeofizike, teknike, ekonomike, duke realizuar ekskluzivitetin e pronësisë së shtetit mbi të dhënat që lidhen me veprimtaritë e kërkimit dhe të prodhimit të hidrokarbureve në Shqipëri, ato historike dhe të krijuara rishtas në sektorin e hidrokarbureve.

Neni 13/2

#### **Agjencia Shtetërore përgjegjëse për Hidrokarburet**

1. Agjencia Shtetërore përgjegjëse për Hidrokarburet varet nga ministria që mbulon sektorin e hidrokarbureve dhe ka këto kompetenca:

a) zbaton politikën e Qeverisë në fushën e hidrokarbureve;

b) merr pjesë në negociimin e marrëveshjeve hidrokarbure me persona, vendas e të huaj, në përputhje me përcaktimet në rregulloren përkatëse;

c) përgatit dokumentacionin dhe praktikën e nevojshme për dhënien e lejeve, të licencave, të autorizimeve, në përputhje me këtë ligj, të cilat mundësojnë hyrjen në marrëveshjet hidrokarbure dhe kryerjen e operacioneve hidrokarbure, sipas marrëveshjeve të lidhura;

ç) mbikëqyr veprimtarinë hidrokarbure dhe ndjek zbatimin e marrëveshjeve të lidhura hidrokarbure.

2. Agjencia bashkëpunon me Institutin Shkencor të Hidrokarbureve për të gjitha problemet shkencore në fushën e hidrokarbureve, si dhe për studime, oponenta, konsulencë dhe asistencë teknike.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë.

Neni 13/3

1. Të ardhurat e përftuara nga marrëveshjet hidrokarbure, me përjashtim të të ardhurave që krijohen nga pagimi i rentës minerare dhe të detyrimeve të tjera fiskale, shpërndahen në favor të institucioneve të përcaktuara në nenet 13/1 dhe 13/2, të këtij ligji. Shpërndarja e këtyre të ardhurave bëhet nga ministri, pas verifikimit të nevojave të këtyre institucioneve për vitin përkatës financiar.

2. Me qëllim zbatimin e pikës 1, të këtij neni, Agjencia Shtetërore përgjegjëse për Hidrokarburet përcjell pranë ministrit planifikimin e të ardhurave nga marrëveshjet hidrokarbure brenda muajit të parë të çdo viti.

Neni 13/4

Aktiviteti i kërkimit dhe prodhimit të lëndëve hidrokarbure kryhet nga ekspertë të pajisur me certifikatën e lejes profesionale për veprimtarinë studimore-projektuese e zbatuese për kërkimin dhe prodhimin e naftës e të gazit. Ky parashikim nuk zbatohet për ekspertët e huaj, të cilët ushtrojnë aktivitete që nuk kalojnë një periudhë prej 12 muajsh, nga data e hyrjes së ekspertëve në territorin shqiptar.

Neni 13/5

Regjimi fiskal, duke përfshirë, por pa u kufizuar në përqindje, forma, mënyra e ndarjes dhe afatet e pagesës së detyrimeve tatimore përcaktohen sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

Neni 13/6

Kudo në ligj, fjalët “standardet e aplikueshme ndërkombëtare” ose të barasvlershme me to zëvendësohen me fjalët “standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në industrinë e hidrokarbureve”.

Neni 8

#### **Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin përkatës nënligjore në zbatim të neneve 13/1, pika 1, dhe 13/2, pika 3, të këtij ligji.



Neni 9

**Marrëveshjet hidrokarbure të nënshkuara**

Ky ligj nuk zbatohet për marrëveshjet hidrokarbure të nënshkuara dhe ato, për të cilat procesi i negocimit ka filluar para hyrjes së tij në fuqi.

Neni 10

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.2.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10005, datë 15.2.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ**

Nr. 7/2017

**PËR NXITJEN E PËRDORIMIT TË  
ENERGJISË NGA BURIMET E  
RINOVUESHME<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është:

a) të nxitë rritjen e prodhimit të energjisë prej burimeve të rinovueshme për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me detyrimet në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë;

<sup>1</sup> Ky ligj është përafuar pjesërisht me Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 23 prill 2009, “Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE”, të ndryshuar”, Numri CELEX: 32009L0028, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 140, datë 5.6.2009, faqe 16–62.

b) të zvogëlojë importin e lëndëve djegëse organike, emetimin e gazeve me efekt serrë dhe të mbrojtë mjedisin, në zbatim të detyrimeve të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare;

c) të nxitë zhvillimin e tregut të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme dhe integrimin rajonal të tij;

ç) të rritë diversifikimin e përdorimit të burimeve të energjisë dhe sigurinë e furnizimit me energji në Republikën e Shqipërisë;

d) të nxitë zhvillimin rural dhe të zonave të izoluara, duke përmirësuar furnizimin me energji të këtyre zonave.

Neni 2

**Fusha e veprimt**

Ky ligj përcakton:

a) kuadrin ligjor për nxitjen e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë;

b) objektivat kombëtarë të detyrueshëm për kontributin e burimeve të rinovueshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë;

c) rregullat për mbështetjen e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme;

ç) detyrimin për transparencën e informacionit;

d) rregullat për aksesin dhe funksionimin e rrjeteve për burimet e energjive të rinovueshme dhe lidhjen e tyre me rrjetin e energjisë elektrike në territorin e Republikës së Shqipërisë;

dh) rregullat për dhënien, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë e prodhuar nga burimet e rinovueshme;

e) monitorimin e zbatimit e të raportimit të kërkesave të ligjit.

Neni 3

**Përkufizime**

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Energji aerotermale” është energjia e depozituar në formën e nxehtësisë në ajrin e ambientit.

b) “Energji gjeotermike” është energjia e depozituar në formën e nxehtësisë nën sipërfaqen e tokës.

c) “Energji hidrotermike” është energjia e depozituar në formën e nxehtësisë në ujërat sipërfaqësore.

ç) “Biomasa” është pjesa e biodegradueshme e produkteve, mbeturinave dhe mbetjeve me origjinë



biologjike nga veprimtaria bujqësore (përfshirë lëndë bimore dhe shtazore), pyjore dhe nga industri të lidhura me to, përfshirë peshkimin dhe akuakulturën, si edhe pjesa e biodegradueshme e mbeturinave industriale, urbane dhe rurale.

d) “Biolëngjet” janë lëndë djegëse në trajtë të lëngët ose të gaztë, të përziera me lëndë djegëse hidrokarbure dhe të prodhuara nga biomasat, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9876, datë 14.2.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport.

dh) “Energjia nga burimet e rinovueshme” është energjia nga burime të rinovueshme jofosile, konkretisht era, dielli, energjia aerotermike, energjia gjeotermike, energjia hidrotermike dhe energjia e oqeanëve, energjia hidrike, biomasa, gazi i grumbulluar në landfillë, gazi, që grumbullohet nga trajtimi i ujërave të zeza dhe biogazet.

e) “Konsumi përfundimtar bruto i energjisë” është gjithë sasia e energjisë, e lëvruar në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllime industriale, për transportin, për sektorin familjar, për shërbimet e ndryshme, përfshirë shërbimet publike e private, bujqësinë, pyjet e peshkimin, konsumin e energjisë elektrike dhe të nxehtësisë edhe për vetëkonsum në të gjithë sektorët e energjisë, si dhe humbjet e energjisë elektrike e të nxehtësisë në sistemin e transmetimit e të shpërndarjes.

ë) “Garancia e origjinës” është një dokument elektronik, i cili ka funksion të vetëm që t’i provojë konsumatorit përfundimtar se një pjesë ose e gjithë sasia e dhënë e energjisë së përdorur është prodhuar prej burimeve të rinovueshme.

f) “Proces konkurrues i ofertave” është një procedurë objektive, transparente, jodiskriminuese që mundëson pjesëmarrjen e një numri shoqërisht, për të përfituar nga skema e mbështetjes, në bazë të ofertës fillestare të paraqitur nga ofertuesi.

g) “Skemë mbështetjeje” është instrumenti, apo mekanizmi i zbatuar për të nxitur përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme duke zvogëluar koston e asaj energjie, duke rritur çmimin me të cilin ajo mund të shitet ose duke rritur vëllimin e energjisë së blerë me anë të detyrimeve për energji të rinovueshme ose mënyra të tjera.

gj) “Kontratë për diferencën” është kontrata, modeli i së cilës miratohet nga Këshilli i Ministrave, ndërmjet Operatorit të Energjisë së Rinovueshme dhe prodhuesit të energjisë nga burimet e

rinovueshme, i cili është deklaruar ofertuesi i suksesshëm në procesin konkurrues për të përfituar nga skema e mbështetjes, sipas përcaktimit të nenit 9 të këtij ligji.

h) “Çmim i caktuar” është çmimi final që do të përfitojë prodhuesi me përparësi i energjisë elektrike, si rezultat i shpalljes fitues i një skeme mbështetëse në një procedurë konkurruese.

i) “Çmimi referencë” është çmimi orar i tregut të ditës në avancë, i cili bazohet në tregun e organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e saj në një treg energjie elektrike të krahasueshëm me të.

j) “Prodhues me përparësi” është çdo prodhues që prodhon energji elektrike nga burime të energjisë së rinovueshme dhe në rastin e energjisë hidrike me një kapacitet të instaluar deri në 15 MW për një njësi gjeneruese dhe që përfitojnë nga skemat mbështetëse, në përputhje me parashikimit e këtij ligji.

k) “Operatori i Energjisë së Rinovueshme” është subjekti përgjegjës, që faturon dhe mbledh detyrimin për energjinë e rinovueshme të aplikuar tek të gjithë klientët fundorë të energjisë elektrike.

l) “Skema e matjes së energjisë neto” është skema që mundëson matjen me dy drejtime të një kapaciteti total të instaluar për prodhimin e energjisë elektrike nga era ose dielli nën 500 kW, nga shoqëritë e vogla dhe të mesme ose klientët familjarë, i cili nuk mund të dispeçerohet. Këta klientë prodhojnë një pjesë ose të gjithë energjinë që nevojitet për nevojat e tyre dhe injektojnë energjinë e tepërt të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes.

ll) “Sistem diellor fotovoltaiik” është një pajisje apo impiant i përdorur për të shndërruar energjinë e rrezatimit diellor në energji elektrike për vetëkonsum apo për ta shpërndarë në rrjetet e energjisë elektrike.

m) “Njësi gjenerimi” është çdo mjet teknik, i cili shndërron energjinë e prodhuar nga burimet e rinovueshme në energji elektrike ose për ngrohje.

n) “Kapacitet i instaluar i një impianti” është fuqia e energjisë elektrike, për të cilën njësi prodhuese është e aftë teknikisht të prodhojë, kur punon siç është planifikuar, pa kufizime kohore, si dhe pa marrë parasysh ndërprerjet e vogla afatshkurtra.

nj) “Prodhuesit ekzistues me përparësi” janë prodhuesit me përparësi, nga burimet hidrike, të





cilët pavarësisht nga momenti i nënshkrimit të kontratës me autoritetin kontraktor, janë pajisur me “Certifikatën e pranimit të veprës”, sipas legjislacionit përkatës, brenda datës 31 dhjetor 2020.

o) “Detyrimi për energjinë e rinovueshme” përfaqëson një tarifë fikse që aplikohet te klientët fundorë, në përputhje me sasinë përkatëse të energjisë elektrike të matur dhe të lëvruar nga furnizuesit te këta klientë. Ky detyrim llogaritet si produkt i totalit të sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë me bonusin e dhënë për promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, në raport me totalin e sasisë së energjisë elektrike të lëvruar nga furnizuesit te klientët fundorë.

p) “Ministria” është ministria përgjegjëse për energjinë.

q) “Ministri” është ministri përgjegjës për energjinë.

2. Të gjithë termat e përdorur në këtë ligj, të cilët nuk janë përfshirë në pikën 1, të këtij neni, do të kenë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë” dhe ligjin nr. 124/2015 “Për eficientë e energjisë”.

## KREU II

### OBJEKTIVAT KOMBËTARË PËR PËRDORIMIN E ENERGJISË NGA BURIMET E RINOVUESHME DHE MASAT PËR REALIZIMIN E TYRE

#### Neni 4

#### Objektivat kombëtarë

1. Objektivat kombëtarë për energjinë e rinovueshme të prodhuar nga burimet e rinovueshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë dhe trajektorja udhëzuese janë përcaktuar në shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij ligji.

2. Pjesa e energjisë nga burimet e rinovueshme përlogaritet si prodhimi përfundimtar bruto i energjisë nga burimet e rinovueshme, përpjesëtuar me konsumin përfundimtar bruto të energjisë nga të gjitha burimet e energjisë, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

3. Për të arritur objektivat e përcaktuar në shtojcën nr. 1, të këtij ligji, Republika e Shqipërisë mund të bashkëpunojë me palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton mënyrën dhe kriteret e bashkëpunimit.

#### Neni 5

#### Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë

1. Ministria, në bashkëpunim me agjencinë përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë, institucionet e tjera përgjegjëse, dhe në konsultim me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, sipas përcaktimeve të nenit 4 të këtij ligji, harton një Plan Kombëtar Veprimi për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, i cili rishikohet çdo dy vjet.

2. Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë përcakton masat për arritjen e objektivave kombëtarë për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, për ngrohjen dhe ftohjen, për transportin, si pjesë e konsumit përfundimtar bruto në vitin 2020, sipas përcaktimit në shtojcën nr.1 të këtij ligji.

3. Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë i miratuar i njoftohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

4. Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë monitorohet prej agjencisë përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë, e cila i paraqet ministrisë raportin vjetor të monitorimit brenda datës 30 qershor të çdo viti.

5. Çdo dy vjet, brenda datës 30 shtator, ministria i paraqet Këshillit të Ministrave një raport për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë dhe përmbushjen e objektivave kombëtarë për energjinë nga burime të rinovueshme. Ky raport publikohet në faqen zyrtare të internetit të ministrisë.

6. Nëse raporti i parashikuar në pikën 5, të këtij neni, paraqet se pjesa e energjisë nga burimet e rinovueshme është më e vogël se një pikë përqindjeje sesa vlera e trajektores udhëzuese për periudhën e dy viteve të ardhshme, të përcaktuar në shtojcën nr. 1, të këtij ligji, ministria i propozon Këshillit të Ministrave ndryshimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, duke përcaktuar masat e duhura dhe të përshtatshme



për të arritur trajektoren udhëzuese, përmendur në shtojcën nr. 1 të këtij ligji.

#### Neni 6

##### **Informacioni, certifikimi dhe statistikat**

1. Ministria merr masa që informacioni rreth përfitimeve, kostove të zhvillimit dhe përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe rreth masave mbështetëse, të jetë i disponueshëm për të gjitha palët e interesuara.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe ministrit përgjegjës për zhvillimin urban, miraton llojet e certifikatave dhe kriteret e nevojshme të certifikimit për instalimet e kaldajave dhe sobave të vogla të biomasës, sistemeve diellore fotovoltaike, termike, termodinamike, sistemeve gjeotermike të cekëta dhe pompat e nxehtësisë. Certifikimi i dhënë prej çdonjërit nga vendet anëtare të Bashkimit Europian ose palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë konsiderohet si i bazuar në këto kritere.

3. Të gjitha subjektet që prodhojnë energji nga burimet e rinovueshme kanë detyrimin të dorëzojnë të dhëna mbi prodhimin vjetor të energjisë, të dhëna mbi pagesën e detyrimeve financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara me udhëzim të ministrit, në agjencinë përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti.

#### Neni 7

##### **Detyrat e agjencisë përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë**

1. Agjencia përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë, si institucion në varësi të ministrit, kryen detyrat si më poshtë:

a) krijimin, regjistrimin dhe përditësimin e regjistrit të prodhuesve me përparësi të energjisë;

b) regjistrimin e bilancit të energjisë të të gjithë prodhuesve me përparësi të energjisë;

c) hartimin dhe dorëzimin në ministri të projektit të Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë në afatet e përcaktuara nga kjo ministri;

ç) monitorimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave;

d) hartimin dhe dorëzimin në ministri dhe ERE, brenda datës 1 qershor të çdo viti, të vlerësimit të pjesës së energjisë së prodhuar nga burimet e

rinovueshme, krahasuar me konsumin përfundimtar bruto të energjisë për vitin paraardhës;

dh) përgatitjen e informacionit të parashikuar në pikën 1, të nenit 6, të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, cakton ose krijon institucionin, i cili do të ushtrojë detyrat e agjencisë përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë.

#### KREU III

##### **NXITJA E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E RINOVUESHME**

#### Neni 8

##### **Masat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme**

1. Me qëllim arritjen e objektivit kombëtar të energjisë së rinovueshme, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton masat për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

2. Mbështetja sipas kontratës për diferencë për prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, përveç rasteve të përcaktuara në këtë ligj, do të jepet nëpërmjet një procesi konkurrues. Mbështetja jepet në formën e një shpërblimi për arritjen e çmimit të caktuar, si një shtesë mbi çmimin e referencës.

3. Ministria, në konsultim me agjencinë përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë, Entin Rregullator të Energjisë dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, harton çdo propozim rreth masave mbështetëse. Kushtet dhe procedurat për dhënien e masave mbështetëse, që përfshijnë ndihmën nga Buxheti i Shtetit, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Këto masa, në çdo rast jepen në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

4. Prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike janë përgjegjës për balancimin. Prodhuesit bëhen palë përgjegjëse për balancimin, duke nënshkruar një kontratë me Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose duke nënshkruar një kontratë për transferimin e përgjegjësisë së balancimit të një palë tjetër përgjegjëse për balancimin, duke u bërë pjesëtar i një grupi balancues, në përputhje me rregullat e tregut dhe procedurat përkatëse të miratuara nga ERE, në konsultim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.



## Neni 9

**Kontrata për diferencë**

1. Mbështetja sipas kontratës për diferencë është e bazuar në një shpërblim të ndryshueshëm, të llogaritur si diferenca midis çmimit me të cilin prodhuesi i energjisë së rinovueshme është shpallur fitues në procesin konkurrues për dhënien e ndihmës (çmimi i caktuar) dhe çmimit të tregut të energjisë elektrike (çmimi referencë).

2. Përfituesit e skemës së mbështetjes, sipas një kontrate për diferencë dhe niveli maksimal për një mbështetje të tillë, do të caktohen në një proces konkurrues, të hapur për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, në bazë të kriterëve të qarta, transparente dhe jodiskriminuese, përveç rasteve kur:

a) vetëm një ose një numër shumë i kufizuar projektesh janë të përshtatshme për një proces konkurrues;

b) një proces konkurrues mund të sjellë një nivel mbështetjeje dukshëm më të lartë; ose

c) një proces konkurrues do të rezultonte dukshëm në çmime të ulëta.

3. Procesi konkurrues mund të kufizohet vetëm në një teknologji specifike, në rastet kur një proces i hapur ndaj të gjithë prodhuesve do të çonte në rezultat jo të përshtatshëm, i cili nuk mund të trajtohet në procesin e projektimit, duke pasur parasysh në veçanti:

a) potencialin afatgjatë të një teknologjie të re dhe inovative;

b) nevojën për të diversifikuar burimet;

c) kufizime të rrjetit dhe qëndrueshmërisë së rrjetit;

ç) kostot e lidhjes në rrjet;

d) nevojën për të shmangur deformimet në tregun e materialeve të para nga mbështetja e biomasës.

4. Modeli i kontratës për diferencë, kushtet dhe procedurat, si dhe rastet e parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, propozohen nga ministri dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Operatori i Energjisë së Rinovueshme do të hartojë një formular aplikimi për mbështetjen, sipas kontratës për diferencë. Formulari i aplikimit përmban ndër të tjera emrin e aplikantit dhe llojin e shoqërisë, një përshkrim të projektit, duke përfshirë vendndodhjen e saj, datën e fillimit e të përfundimit të projektit, sasinë e mbështetjes së

nevojshme për të përfunduar atë dhe kostot përkatëse. Në formularin e aplikimit, përfituesit duhet të përshkruajnë pamundësinë e zhvillimit të projektit pa mbështetjen e kontratës për diferencë.

6. Mbështetja për prodhuesit e energjisë së rinovueshme jepet në çdo rast, deri në vetëshlyerjen e plotë të impiantit, në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe çdo formë mbështetjeje e marrë më parë duhet të zbritet nga mbështetja, sipas kontratës për diferencë.

7. Prodhuesit e energjisë së rinovueshme janë të detyruar të paguajnë diferencën ndërmjet çmimit të referencës dhe çmimit të caktuar tek Operatori i Energjisë së Rinovueshme, në rastet kur çmimi i referencës tejkalon çmimin e caktuar. Nëse çmimi i tregut në bazë orare, në bazë të ankandit të ditës në avancë, do të jetë nën zero për më pak se gjashtë orë radhazi, mbështetja konsiderohet e mbuluar me çmimin e caktuar. Nëse çmimi i tregut në bazë orare, në bazë të ankandit të ditës në avancë, mbetet negativ gjatë një periudhe prej gjashtë orësh ose më gjatë, atëherë shuma e diferencës, sipas kontratës për diferencë, do të jetë zero për gjithë atë periudhë.

8. Kontrata për diferencë do të ketë një kohëzgjatje maksimale prej 15 vjetësh.

## Neni 10

**Masat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme**

1. Mbështetja sipas kontratës për diferencë nuk zbatohet për prodhuesit me përparësi:

a) me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 2 MW;

b) me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 3 MW për energjinë e erës;

c) për projektet demonstruese.

2. Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 2 MW caktohet nga ERE, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, plus një bonus të caktuar për promovimin e këtyre burimeve, i cili merr në konsideratë një kthim të arsyeshëm të vlerës së investimeve. Në çdo rast, ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE në vitin 2016.



3. Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga çdo prodhues tjetër me përparësi, i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, caktohet nga ERE, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur.

4. Në hartimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, ministria merr edhe mendimin nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

#### Neni 11

### Operatori i Energjisë së Rinovueshme

1. Operatori i Energjisë së Rinovueshme është përgjegjës për faturimin dhe mbledhjen nga çdo furnizues i energjisë elektrike të pagesave për detyrimin për energjinë e rinovueshme për të gjitha kategoritë e prodhuesve me përparësi, të aplikuar tek të gjithë klientët fundorë, në përputhje me sasinë përkatëse të energjisë elektrike të matur dhe të lëvruar te këta klientë. Këshilli i Ministrave përcakton operatorin që do kryejë funksionet e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë ligj dhe ligjin e sektorit të energjisë elektrike.

2. Operatori i Energjisë së Rinovueshme është përgjegjës për nënshkrimin dhe administrimin e kontratave për diferencë me prodhuesit me përparësi të energjisë. Kjo përfshin menaxhimin e kontratave gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre, si dhe parashikimin e pagesave, sipas skemave mbështetëse për prodhuesit me përparësi, në përputhje me detyrimin për energjinë e rinovueshme. Operatori i Energjisë së Rinovueshme është gjithashtu, përgjegjës për shlyerjen e shumave të pagueshme për prodhuesit me përparësi.

3. ERE miraton detyrimin për energjinë e rinovueshme që do të paguhet nga ana e klientëve fundorë të energjisë elektrike në një bazë vjetore dhe metodologjinë për përcaktimin e këtij detyrimi, si dhe procedurën e kompensimit të diferencës për prodhuesit.

4. Operatori i Energjisë së Rinovueshme duhet të mbajë të dhëna të hollësishme për të gjitha masat mbështetëse. Këto të dhëna duhet të mbahen gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës për diferencë dhe për një periudhë shtesë prej dhjetë vitesh, duke

përfshirë të gjitha informacionet e nevojshme për të provuar se kushtet e kontratës për diferencë janë përmbushur.

5. Operatori i Energjisë së Rinovueshme publikon çdo vit detajet e llogaritjeve e të shpërblimeve, sipas kontratave për diferencë. Operatori i Energjisë së Rinovueshme kryen një vlerësim të fazës së parë të procesit konkurrues, përfshirë përqindjen e realizuar të projekteve të energjive të rinovueshme të deklaruar fitues në procesin konkurrues, pas marrjes së certifikatës së pranimit të veprës.

#### Neni 12

### Aksesi në rrjet

1. Transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme janë të garantuar, mbi baza transparente, jodiskriminuese dhe bazuar në tarifat e miratuara e të publikuara nga ERE. Prodhuesit që prodhojnë energji nga burime të rinovueshme kanë përparësi në aksesin në rrjetet elektrike.

2. Operatori i Transmetimit dhe Operatori i Shpërndarjes sigurojnë aksesin në rrjetin e tyre, në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike.

3. Kriteret e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përfshihen në marrëveshjen për operimin midis Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë së rinovueshme.

4. ERE miraton masat e nevojshme për operimin e rrjetit, me qëllim minimizimin e ndërprerjeve të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë.

#### Neni 13

### Lidhja me rrjetin

1. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes ndërmarrin hapat e duhur për të zhvilluar infrastrukturën e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes, rrjetet inteligjente, impiantet e depozitimit dhe sistemin e energjisë elektrike, me qëllim që të lejojnë funksionim të sigurt të sistemit të energjisë elektrike, për të përfshirë zhvillimin e mëtejshëm të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë, përfshirë interkonjeksionin me vendet fqinje, në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë.



2. Me propozim të operatorëve të sistemit të transmetimit e të shpërndarjes, ERE miraton procedurat dhe rregullat lehtësuese për lidhjen e impianteve prodhuese në rrjet, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë”, në bashkëpunim me autoritetet qendrore dhe vendore, të përfshira në procedurat për autorizimin, planifikimin dhe dhënien e lejeve në nivelin vendor dhe kombëtar.

3. Operatorët e sistemit të transmetimit e të shpërndarjes, bazuar në kërkesën e prodhuesit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe në përputhje me kodet dhe rregulloret e miratuara nga ERE, propozojnë si pikë lidhjeje me rrjetin e tyre atë pikë që plotëson kushtet më të favorshme për prodhuesin e energjisë së rinovueshme nga pikëpamja e kostos dhe largësisë nga rrjeti. Në përzgjedhjen e pikës së lidhjes më të mirë dhe më të përshtatshme, operatorët e sistemit të transmetimit e të shpërndarjes duhet të marrin në konsideratë kufizimet teknike e efikasitetin ekonomik të pikës së përzgjedhur të lidhjes me rrjetin. Operatorët e sistemit të transmetimit e të shpërndarjes duhet t'i sigurojnë çdo prodhuesi të ri të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, që dëshiron të lidhet në rrjet, informacionin e kërkuar të nevojshëm dhe të kuptueshëm, duke përfshirë:

- a) një vlerësim të detajuar dhe të kuptueshëm mbi kostot e pikës së lidhjes;
- b) një kohëzgjatje të saktë e të arsyeshme për marrjen dhe shqyrtimin e kërkesës për lidhjen në rrjet;
- c) një afat kohor për miratimin e çdo lidhjeje të propozuar në rrjet.

Neni 14

#### **Kostot për lidhjen me rrjetin dhe zgjerimin e kapaciteteve**

1. Shpenzimet e nevojshme të lidhjes së impianteve të gjenerimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë në pikën e lidhjes dhe pajisjet e nevojshme matëse për të regjistruar energjinë elektrike të furnizuar e të lëvruar përballohen nga prodhuesi i energjisë së rinovueshme.

2. Në qoftë se operatori i rrjetit pas miratimit të lidhjes me rrjetin, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji, cakton një pikë tjetër lidhjeje, ai duhet të mbulojë kostot shtesë që i shkaktohen prodhuesit.

3. Operatori i rrjetit duhet të përballojë kostot e optimizimit, të përforcimit dhe të zgjerimit të sistemit të rrjetit.

Neni 15

#### **Skemat e matjes neto të energjisë**

1. Në përputhje me skemën e matjes, një shoqëri e vogël ose e mesme apo një klient familjar mund të instalojë një kapacitet total deri në 500 kW për prodhimin e energjisë elektrike nga era ose dielli për të mbuluar një pjesë ose të gjithë energjinë që nevojitet për nevojat e tij dhe të injektojë energjinë e tepërt të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes.

2. Klientët, sipas skemës së matjes neto të energjisë, duhet të instalojnë me shpenzimet e tyre një matës me dy drejtime.

3. Bilanci neto dhe faturimi bëhen në baza mujore për secilën pikë matëse. Teprica e energjisë elektrike më e madhe se konsumi mujor shitet te furnizuesi i shërbimit universal, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, sipas çmimit të caktuar nga ERE, bazuar në metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

4. Ministri miraton me udhëzim një procedurë të lehtësuar për autorizimin për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të energjisë së rinovueshme.

KREU IV

#### **GARANCIA E ORIGJINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E RINOVUESHME**

Neni 16

#### **Garancia e origjinës**

1. Me kërkesën e prodhuesit të energjive të rinovueshme, ERE duhet të lëshojë garancinë e origjinës për çdo njësi të energjisë të gjeneruar nga impianti, pas marrjes së të drejtës për ndërtimin e impiantit të energjisë së rinovueshme.

2. Garancia e origjinës lëshohet në formatin standard dhe për një njësi të energjisë elektrike 1 MWh duhet të përcaktojë:

- a) burimin e energjisë, nga i cili prodhohet energjia;
- b) datën e fillimit e të përfundimit të prodhimit;
- c) emrin, vendin, tipin dhe kapacitetin e impiantit ku është prodhuar energjia;



ç) nëse prodhuesi ka përfituar prej mbështetjes me investime ose nga skema të tjera të mbështetjes në nivel kombëtar dhe masën e këtij përfitimi;

d) datën e autorizimit të impiantit dhe kohën kur është futur në punë;

dh) datën, vendin e lëshimit të garancisë dhe një numër identifikimi unik.

3. Garancia e origjinës mund të transferohet, veçmas ose së bashku me transferimin fizik të energjisë, dhe nuk do të ketë efekt në vendimin për të përdorur mekanizmin e bashkëpunimit për arritjen e objektivit apo në llogaritjen e konsumit final bruto të energjisë nga burime të rinovueshme, në përputhje me nenin 4 të këtij ligji.

4. ERE duhet mbajë një regjistër elektronik të garancive të origjinës me një mekanizëm të përshtatshëm të përpunimit të të dhënave për të siguruar se garancitë e origjinës lëshohen, transferohen dhe anulohen në mënyrë elektronike dhe janë të sakta, të besueshme dhe jo të manipulueshme. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ketë akses lirisht në këtë regjistër.

5. ERE monitoron lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës dhe siguron se e njëjta njësi e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme është marrë në konsideratë vetëm një herë.

6. Garancia e origjinës lëshohet bazuar në të dhëna të kuptueshme dhe informacion të duhur për të certifikuar origjinën e energjisë elektrike të furnizuar nga prodhuesi, si dhe të dhënat e matura të certifikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Garancia e origjinës lëshohet vetëm nëse prodhuesi jep të gjithë informacionin e kërkuar, sipas pikës 2 të këtij neni.

7. Prodhuesit nuk i jepet mbështetje kur ai prodhues merr një certifikatë origjine për të njëjtin prodhim energjie nga burime të rinovueshme.

8. Përdorimi i garancisë së origjinës është i vlefshëm brenda 12 muajve prej prodhimit të njësisë së energjisë elektrike korresponduese. Garancia e origjinës duhet të anulohet pas përdorimit të saj.

9. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar të provojë pjesën apo sasinë e energjisë nga burimet e rinovueshme në totalin e energjisë së përzier, me qëllim që t'u japë konsumatorëve informacionin rreth konsumit të energjisë nga

burime të rinovueshme duke përdorur edhe garancinë e origjinës.

10. Sasia e energjisë nga burimet e rinovueshme që i korrespondon garancisë së origjinës, e transferuar prej një furnizuesi të energjisë elektrike te një palë e tretë, duhet zbritur prej pjesës së energjisë nga burimet e rinovueshme në totalin e energjisë së përzier, sipas përcaktimit në pikën 7 të këtij neni.

11. Nëse energjia elektrike është prodhuar nga një hidrocentral me sistemin e rezervës së pompuar prej ujit të pompuar më parë nga poshtë lart, garancia e origjinës lëshohet vetëm për atë sasi të energjisë elektrike që i korrespondon diferencës midis energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentrali dhe energjisë elektrike të konsumuar prej sistemit të rezervës së pompuar.

12. Nëse energjia elektrike është prodhuar prej mbetjeve urbane apo industriale, garancia e origjinës lëshohet vetëm për sasinë e energjisë që i korrespondon pjesës së biodegradueshme, sipas përcaktimit në shkronjën “ç”, të pikës 1, të nenit 3, të këtij ligji.

13. ERE miraton një rregullore të veçantë për krijimin e një sistemi të saktë, të besueshëm e të mbrojtur nga abuzimet për lëshimin, transferimin dhe revokimin e garancive të origjinës. Kjo rregullore, ndërmjet të tjerave, përcakton në mënyrë të veçantë:

a) dokumentacionin që duhet dorëzuar nga prodhuesi për cilësitë teknike të impiantit të tij si njësi prodhuese e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë;

b) procedurën teknike të kualifikimit dhe veçanërisht kufirin kohor, në të cilin ERE përgjigjet për aplikimet e dorëzuara dhe pasojat ligjore që rrjedhin prej dështimit të zbatimit të këtij detyrimi;

c) procedurën e aplikimit për lëshimin, regjistrimin, transferimin dhe anulimin e garancisë së origjinës;

ç) procedurën e monitorimit e të verifikimit të saktësisë dhe besueshmërisë së detyrimeve të përmbushura nga prodhuesi;

d) çështjet lidhur me bashkëpunimin me autoritetet kompetente të vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve të tjera, me të cilat ka marrëveshje të nënshkruara për njohjen e ndërsjellë të garancive të origjinës.



Neni 17

### Procedura e monitorimit

1. Për të siguruar përmbushjen e kushteve të lëshimit të garancisë së origjinës dhe se të dhënat, mbi të cilat është lëshuar ajo, janë ta sakta, përfaqësuesit e ERE-s dhe çdo person i autorizuar prej saj, pa paragjykime lidhur me respektimin e sekretit tregtar, kanë akses të lirë në impiantin përkatës të prodhimit dhe në të gjitha të dhënat dhe informacionin për atë impiant të dhënë. Prodhuesi është i detyruar të lehtësojë punën e përfaqësuesve të ERE-s dhe të personave të autorizuar prej tij.

2. ERE mund të refuzojë njohjen e garancisë së origjinës vetëm kur ka dyshime të bazuara për saktësinë, besueshmërinë ose vërtetësinë e saj. ERE njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për çdo refuzim së bashku me arsyet për këtë refuzim. Mendimi i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë merret parasysh nga ERE në njohjen e garancive të origjinës.

Neni 18

### Bashkëpunimi ndërkombëtar për garancitë e origjinës

1. Një garanci e origjinës për energjinë elektrike të gjeneruar nga burime të rinovueshme të energjisë, e lëshuar nga një vend anëtar i BE-së ose nga një vend, i cili është palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, do të njihet edhe nga Republika e Shqipërisë.

2. ERE punon ngushtësisht me të gjitha autoritetet që lëshojnë garanci të origjinës në vendet anëtare të BE-së dhe me çdo vend, i cili është palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, me qëllim për t'u vënë në dispozicion konsumatorëve fundorë informacionin për pjesën e energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë, si pjesë e energjisë totale të furnizuar.

KREU V

### ENERGJIA E BURIMEVE TË RINOVUESHME NË TRANSPORT DHE PËR PRODHIMIN E UJIT TË NGROHTË

Neni 19

### Përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në transport

Përmbushja e detyrimeve kombëtare për energjinë nga burimet e rinovueshme për qëllimet e përdorimit të energjisë prej burimeve të

rinovueshme në të gjitha llojet e transportit, sipas objektivave kombëtarë për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, në përputhje me nenin 4, të këtij ligji, realizohet nëpërmjet legjislacionit për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport.

Neni 20

### Objektivat minimalë për përdorimin e energjisë diellore për prodhimin e ujit të ngrohtë

1. Këshilli i Ministrave përcakton treguesit minimalë për prodhimin e ujit të ngrohtë urban për përdorim higjienik dhe për proceset teknologjike, i përfutur prej sistemeve të paneleve diellore.

2. Treguesit minimalë për përdorimin e energjisë diellore, të përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, vendosen duke marrë në konsideratë sasinë e rrezatimit diellor për zonat e ndryshme të vendit.

3. Këshilli i Ministrave miraton kriteret specifike për përlllogaritjen e energjisë diellore të përdorur për të përfutur ujë të ngrohtë, qoftë në mënyrë të veçantë apo si pjesë e kodit të energjisë së banesave, duke marrë në konsideratë standardet më të fundit të BE-së, të miratuara për këtë qëllim.

KREU VI

### DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21

### Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, pikat 2 e 3; 5, pika 3; 6, pika 2; 7, pika 2; 8, pikat 1 e 3; 9, pika 4; 10, pikat 2 e 3; 15 pika 3; 20, pikat 1 e 3; dhe 22, pikat 2 e 4, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjëse për energjinë që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 3; 15, pika 4; dhe 22, pika 1, të këtij ligji.

3. Ngarkohet Enti Rregullator i Energjisë që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 4; 11, pika 3; 12, pika 4; 13, pika 2; dhe 16, pika 13, të këtij ligji.



Neni 22

**Trajtimi i prodhuesve ekzistues me përparësi**

1. Prodhuesit me përparësi, të cilët kanë marrë certifikatën e pranimit të veprës të centralit elektrik, brenda datës 31 dhjetor 2020, kanë të drejtë të zgjedhin për të përfituar nga skema e mbështetjes, sipas kontratës për diferencë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe procedurave të miratuara nga ERE. Certifikata e pranimit të veprës lëshohet nga autoriteti kontraktor, sipas udhëzimit të ministrit.

2. Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi, të cilët kanë marrë certifikatën e pranimit të veprës të centralit elektrik brenda datës 31 dhjetor 2020, dhe të cilët nuk janë bërë pjesë e skemës mbështetëse, sipas kontratës për diferencë, llogaritet nga ERE, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Kjo metodologji hartohet në konsultim me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë.

3. Metodologjia e parashikuar në pikën 2 të këtij neni përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, plus një bonus të caktuar për promovimin e këtyre burimeve, i cili merr në konsideratë një kthim të arsyeshëm të vlerës së investimeve. Në çdo rast, ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE në vitin 2016.

4. Detyrimi i blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, që nuk përfitojnë nga skema e mbështetjes, sipas kontratës për diferencë, konsiderohet detyrim i shërbimit publik dhe i

ngarkohet një të licencuari nga ERE, në përputhje me kushtet dhe procedurat e miratuara nga Këshilli i Ministrave.

5. Deri në krijimin e tregut të balancimit, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2022, prodhuesit ekzistues me përparësi nuk do të jenë përgjegjës për kostot e disbalancave të shkaktuara. Këto kosto do të merren në konsideratë nga ERE në tarifën e shpërndarjes së energjisë elektrike. Prodhuesit ekzistues me përparësi do të njoftojnë skedulën e prodhimit tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike.

Neni 23

**Shfuqizime**

Ligji nr. 138/2013 “Për burimet e energjisë së rinovueshme”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 24

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.2.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10006, datë 15.2.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

SHTOJCA NR. 1

1. Objektivi i përgjithshëm i Shqipërisë për energjinë nga burimet e rinovueshme të energjisë në konsumin përfundimtar bruto të energjisë është 38 për qind në vitin 2020.

2. Trajektorja udhëzuese, e përshkruar në nenin 4, të këtij ligji, përmban treguesit e mëposhtëm të pjesës së energjisë nga burimet e rinovueshme:

Pjesa e energjisë së rinovueshme të Shqipërisë në vitin 2009	Mesatarja për 2011-2012	Mesatarja për 2013-2014	Mesatarja për 2015-2016	Mesatarja për 2017-2018	Objektivi për energjinë e rinovueshme të Shqipërisë në vitin 2020
31,2 %	32,6 %	33,2 %	34,3 %	35,6 %	38 %





**LIGJ**  
Nr. 9/2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9288, DATË 7.10.2004, “PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS “PËR MBROJTJEN E INDIVIDËVE NË LIDHJE ME PËRPUNIMIN AUTOMATIK TË TË DHËNAVE PERSONALE””**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 122, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9288, datë 7.10.2004, “Për ratifikimin e konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale””, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Në përputhje me paragrafin e dytë, të nenit 13, të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se organi i caktuar për bashkëpunim ndërmjet palëve është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me adresë: Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë, Shqipëri.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.2.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10007, datë 15.2.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ**  
Nr. 10/2017

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN PËR MASAT E SHTETEVE PORTUALE PËR TË PARANDALUAR, FRENUAR DHE ELIMINUAR PESHKIMIN E PALIGJSHËM, TË PARAPORTUAR DHE TË PARREGULLUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen për masat e shteteve portuale për të parandaluar, frenuar dhe eliminuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.2.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10008, datë 15.2.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**  
PËR MASAT E SHTETEVE PORTUALE PËR PARANDALIMIN, FRENIMIN DHE ELIMINIMIN E PESHKIMIT TË PALIGJSHËM, TË PARAPORTUAR DHE TË PARREGULLUAR

PREAMBULË

Palët e kësaj Marrëveshjeje,  
të shqetësuaru thellësisht për vazhdimësinë e peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar dhe pasojat e tij negative në rezervat e peshkut, ekosistemin detar dhe mjetet e jetesës së peshkatarëve të ligjshëm, dhe për nevojën në rritje për siguri ushqimore në nivel global;



*të ndërgjegjshëm* për rolin e shtetit portual në miratimin e masave efektive për të nxitur përdorimin e qëndrueshëm dhe konservimin afatgjatë të burimeve të gjalla detare;

*ndërsa pranojnë* që masat për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar duhet të ngrihen mbi përgjegjësinë parësore të shteteve të flamurit dhe të përdorin të gjitha kompetencat në dispozicion në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, përfshirë masat e shtetit portual, masat e shtetit bregdetar, masat e lidhura me tregun dhe masat për të siguruar që shtetasit të mos mbështetin ose të mos përfshihen në peshkim të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar;

*ndërsa pranojnë* që masat e shtetit portual ofrojnë një mënyrë të fuqishme dhe efektive për të parandaluar, frenuar dhe eliminuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar;

*të ndërgjegjshme* për nevojën për të rritur koordinimin në nivel rajonal dhe ndërrajonal për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar nëpërmjet masave të shtetit portual, duke njohur teknologjitë e komunikimit në zhvillim të shpejtë, bazat e të dhënave, rrjetet dhe të dhënat globale që mbështesin masat e shtetit portual;

*ndërsa pranojnë* nevojën për të ndihmuar vendet në zhvillim që të miratojnë dhe zbatojnë masa të shtetit portual;

*duke pasur parasysh* thirrjet nga komuniteti ndërkombëtar nëpërmjet Sistemit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Asambleenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe Komitetin mbi Peshkimin e Organizatës për Ushqim dhe Bujqësi të Kombeve të Bashkuara, më poshtë i referuar “FAO”, për një instrument ndërkombëtar të detyrueshëm për standardet minimale për masat e shtetit portual, bazuar në Planin Ndërkombëtar të Veprimit 2001 të FAO-s për të parandaluar, frenuar dhe eliminuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar dhe Skemën Model 2005 të FAO-s për masat e shtetit portual për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar;

*duke pasur parasysh* që në ushtrimin e sovranitetit të tyre mbi portet që ndodhen në territorin e tyre, shtetet mund të miratojnë masa më të rrepta në përputhje me të drejtën ndërkombëtare;

*duke kujtuar* dispozitat përkatëse të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit të

10 dhjetorit 1982, më poshtë e referuar “Konventa”;

*duke kujtuar* Marrëveshjen për Zbatimin e Dispozitave të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit të 10 dhjetorit 1982, në lidhje me Ruajtjen dhe Menaxhimin e rezervave që ndodhen brenda zonës ekonomike ekskluzive të një ose më shumë shteteve dhe në det të hapur dhe rezervave tipike migratore të 4 dhjetorit 1995, Marrëveshjen për Nxitjen e Përputhshmërisë me Masat Ndërkombëtare për Konservimin dhe Menaxhimin nga Anijet e Peshkimit në Det të Hapur të 24 nëntorit 1993 dhe Kodin e Sjelljes 1995 të FAO-s për Peshkim të Përgjegjshëm;

*ndërsa njohin nevojën* për të lidhur një marrëveshje ndërkombëtare brenda kuadrit të FAO-s, sipas nenit XIV të Kushtetutës së FAO-s,

kanë rënë dakord si më poshtë:

#### PJESA 1

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1

##### **Përdorimi i termave**

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

a) “masa konservimi dhe menaxhimi” do të thotë masa për të ruajtur dhe menaxhuar burimet e gjalla detare që janë miratuar dhe zbatuar në përputhje me rregullat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë ato që janë pasqyruar në Konventë;

b) “peshq” do të thotë të gjitha speciet e burimeve të gjalla detare, qofshin ato të përpunuara apo jo;

c) “peshkim” do të thotë kërkimi, tërheqja, gjetja e vendndodhjes, zënia, marrja ose vjelja e peshqve ose çdo veprimtari që në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të rezultojë në tërheqjen, përcaktimin e vendndodhjes, zënien, marrjen ose vjeljen e peshqve;

d) “veprimtari që lidhen me peshkimin” do të thotë çdo veprim që mbështet ose përgatit peshkim, përfshirë zbarkimin, paketimin, përpunimin, transbordimin ose transportimin e peshqve që nuk janë zbarkuar më përpara në një port, si edhe pajisjen me personel, lëndë djegëse, mjete peshkimi dhe furnizimeve të tjera në det;

e) “peshkim i paligjshëm, i paraportuar dhe i parregulluar” i referohet veprimtarive të



përcaktuara në paragrafin 3 të Planit Ndërkombëtar të Veprimit 2001 të FAO-s për të Parandaluar, Frenuar dhe Eliminuar Peshkimin e Paligjshëm, të Paraportuar dhe të Parregulluar, më poshtë i referuar si “peshkimi PPP”;

f) “Palë” do të thotë një shtet ose organizatë rajonale e integritit ekonomik që ka pranuar që kjo Marrëveshje të jetë e detyrueshme për atë palë dhe për të cilën kjo Marrëveshje është në fuqi;

g) “port” përfshin terminalin në det të hapur dhe struktura të tjera për zbarkim, transbordim, paketim, përpunim, rifurnizim me lëndë djegëse ose me mjete;

h) “organizatë rajonale e integritit ekonomik” do të thotë një organizatë rajonale për integritimin ekonomik së cilës shtetet anëtare i kanë transferuar kompetencë mbi çështje që mbulon kjo Marrëveshje, duke përfshirë autoritetin për të marrë vendimet e detyrueshme mbi shtetet e saj anëtare, në lidhje me këto çështje;

i) “organizata rajonale për menaxhimin e peshkimit” do të thotë organizatë ose strukturë ndërqeveritare peshkimi, sipas rastit, me kompetencë për të marrë masa konservimi dhe menaxhimi; dhe

j) “mjet lundrimi” do të thotë çdo mjet, anije e tjetër lloji ose varkë që përdoret, e pajisur për t’u përdorur ose e caktuar që të përdoret për peshkim ose veprimtari që lidhen me peshkimin.

## Neni 2 Objektivi

Objektivi i kësaj Marrëveshjeje është të parandalojë, frenojë dhe eliminojë peshkimin PPP nëpërmjet zbatimit të masave të efektshme të shtetit portual dhe me anë të tyre të sigurojë konservimin afatgjatë dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla detare dhe ekosistemeve detare.

## Neni 3 Zbatimi

1. Çdo Palë, në cilësinë e saj si shtet portual, zbaton këtë Marrëveshje në lidhje me mjetet e lundrimit që nuk kanë të drejtë të mbajnë flamurin e saj, të cilat kërkojnë të hyjnë në portet e saj ose janë në një nga portet e saj, përveçse për:

a) mjetet e lundrimit të një shteti fqinj, të cilat janë përfshirë në peshkim artizanal si mjet jetese, me kusht që shteti portual dhe shteti i flamurit të

bashkëpunojnë për të siguruar që këto mjete lundrimi të mos përfshihen në peshkim PPP ose veprimtari që lidhen me peshkimin të cilat e mbështesin këtë lloj peshkimi; dhe

b) mjete lundrimi kontejner mbajtëse që nuk mbajnë peshqit ose nëse i mbajnë, vetëm peshkun që është zbarkuar më përpara, nëse nuk ka arsye të qarta për të dyshuar që këto mjete lundrimi janë përfshirë në veprimtari që lidhen me peshkimin të cilat e mbështesin peshkimin PPP.

2. Një Palë, në cilësinë e saj si shtet portual, mund të vendosë të zbatojë këtë Marrëveshje për mjetet e lundrimit të marra me qira nga shtetasit e saj në mënyrë ekskluzive për peshkimin në zona nën juridiksionin e saj dhe që veprojnë në autoritetin e saj në këto zona. Këto mjete u nënshtrohen masave nga Pala që janë po aq efektive sa masat që zbatohen në lidhje me mjetet e lundrimit që mbajnë flamurin e saj.

3. Kjo Marrëveshje zbatohet për peshkimin në zona detare, i cili është i paligjshëm, i paraportuar dhe i parregulluar, siç përkufizohet në nenin 1(e) të kësaj Marrëveshjeje dhe për veprimtaritë që lidhen me peshkimin të cilat mbështesin këtë peshkim.

4. Kjo Marrëveshje zbatohet në mënyrë të drejtë, transparente dhe jodiskriminuese, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

5. Meqë kjo Marrëveshje ka fushëveprimi globale dhe zbatohet për të gjitha portet, Palët inkurajojnë të gjitha subjektet e tjera që të zbatojnë masat në përputhje me dispozitat e saj. Ato që nuk mund të bëhen palë të kësaj Marrëveshjeje mund të shprehin angazhimin e tyre për të vepruar në përputhje me dispozitat e saj.

## Neni 4 Marrëdhënia me të drejtën ndërkombëtare dhe instrumente të tjera ndërkombëtare

1. Asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk cenon të drejtat, kompetencat dhe detyrat e Palëve sipas së drejtës ndërkombëtare. Në veçanti, asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje, nuk do të interpretohet si e tillë që ndikon në:

a) sovranitetin e Palëve mbi ujërat e tyre të brendshme, të arkipelagut dhe tokësore ose të drejtat e tyre sovrane mbi shelfin e tyre kontinental dhe në zonën ekskluzive ekonomike;

b) ushtrimin e sovranitetit të tyre nga Palët mbi portet në territorin e tyre në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën e



tyre për të mohuar hyrjen në to, si edhe për të miratuar masa më të rrepta të shtetit portual sesa ato që parashikon kjo Marrëveshje, përfshirë masat e miratuara sipas një vendimi të një organizate rajonale të menaxhimit të peshkimit.

2. Një Palë, në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, nuk detyrohet nga masat ose vendimet e një organizate rajonale për menaxhimin e peshkimit në të cilën nuk është anëtare apo nuk detyrohet të njohë një organizatë të tillë.

3. Një Palë, nuk detyrohet sipas kësaj Marrëveshjeje, në asnjë rast, që të miratojë masat ose vendimet e një organizate rajonale për menaxhimin e peshkimit nëse këto masa ose vendime nuk janë miratuar në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

4. Kjo Marrëveshje interpretohet dhe zbatohet në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, duke pasur parasysh rregullat dhe standardet e zbatueshme ndërkombëtare, përfshirë ato të përcaktuara nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare Detare, si edhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare.

5. Palët me mirëbesim përmbushin detyrimet e tyre të ndërmarra sipas kësaj Marrëveshjeje dhe ushtrojnë të drejtat që njihen në të në mënyrë të tillë që të mos përbëjë abuzim me të drejtën.

#### Neni 5

##### **Integrimi dhe koordinimi në nivel rajonal**

Çdo Palë, në masën më të madhe të mundshme:

a) integron ose koordinon masat e shtetit portual në lidhje me peshkimin me sistemin më të gjerë të kontrolleve të shtetit portual;

b) integron masat e shtetit portual me masa të tjera për të parandaluar, frenuar dhe eliminuar peshkimin PPP dhe veprimtaritë që lidhen me peshkimin të cilat mbështesin këtë peshkim, duke pasur parasysh Planin Ndërkombëtar të Veprimit 2001 të FAO-s për të Parandaluar, Frenuar dhe Eliminuar Peshkimin e Paligjshëm, të Paraportuar dhe të Parregulluar;

dhe

c) merr masa për të shkëmbyer informacion mes agjencive të duhura kombëtare dhe për të koordinuar veprimtaritë e këtyre agjencive në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 6

##### **Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit**

1. Palët, për të promovuar zbatimin e efektshëm të kësaj Marrëveshjeje dhe duke pasur parasysh kërkesat e duhura të konfidencialitetit, bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion me shtetet përkatëse, FAO-n, organizata të tjera ndërkombëtare dhe organizata rajonale për menaxhimin e peshkimit, përfshirë masat e miratuara nga këto organizata rajonale për menaxhimin e peshkimit në lidhje me objektivin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo Palë, në masën më të madhe të mundshme, merr masat për të mbështetur masat e konservimit dhe menaxhimit të miratuara nga shtetet e tjera dhe organizatat e tjera të rëndësishme ndërkombëtare.

3. Palët bashkëpunojnë, në nivel lokal, rajonal dhe global, në zbatimin e efektshëm të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë, sipas rastit, nëpërmjet FAO-s ose organizatave dhe strukturave rajonale për menaxhimin e peshkimit.

#### PJESA 2

##### **HYRJA NË PORT**

#### Neni 7

##### **Përcaktimi i porteve**

1. Çdo Palë përcakton dhe publikon portet ku mjetet e lundrimit mund të kërkojnë të hyjnë sipas kësaj Marrëveshjeje. Çdo Palë i dërgon FAO-s një listë të porteve të caktuara, e cila do të publikohet siç duhet.

2. Çdo Palë, në masën më të madhe të mundshme, sigurohet që çdo port i përcaktuar dhe i publikuar sipas paragrafit 1 të këtij neni të ketë kapacitet të mjaftueshëm për të kryer inspektimin sipas kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 8

##### **Kërkesa paraprake për hyrje në port**

1. Çdo Palë, si standard minimal, kërkon që t'i jepet informacioni sipas aneksit A përpara se një anijeje t'i lejohet hyrja në port.

2. Çdo Palë kërkon që informacioni i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni të jepet paraprakisht mjaftueshëm për t'i dhënë kohë të mjaftueshme shtetit portual që të shqyrtojë këtë informacion.



## Neni 9

**Hyrja në port, autorizimi apo refuzimi**

1. Pasi merr informacionin e rëndësishëm të kërkuar sipas nenit 8, si edhe informacion tjetër që mund të kërkohej për të përcaktuar nëse anija që kërkon të hyjë në port është përfshirë në peshkim PPP apo veprimtari që lidhen me peshkimin, të cilat e mbështesin këtë peshkim, çdo Palë vendos nëse do të autorizojë apo refuzojë hyrjen e anijes në portin e saj dhe i komunikon këtë vendim anijes apo përfaqësuesit të saj.

2. Në rastin e autorizimit të hyrjes, kapitenit të anijes ose përfaqësuesit të anijes i kërkohej që të paraqesë autorizimin për hyrje tek autoritetet kompetente të Palës sapo anija të mbërrijë në port.

3. Në rastin e refuzimit të hyrjes, çdo Palë i komunikon vendimin e saj të marrë sipas paragrafit 1 të këtij neni shtetit të flamurit që mban anija dhe, sipas rastit dhe në masën e mundshme, shteteve përkatëse bregdetare, organizatave rajonale për menaxhimin e peshkimit dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

4. Pa cenuar paragrafin 1 të këtij neni, kur një Palë ka të dhëna të mjaftueshme që një anije, e cila kërkon të hyjë në port është përfshirë në peshkim PPP ose veprimtari që lidhen me peshkimin të cilat e mbështesin këtë peshkim, sidomos që një anije është përfshirë në listën e anijeve të cilat janë marrë me peshkim PPP ose veprimtari që lidhen me peshkimin të cilat e mbështesin këtë peshkim, listë kjo që është miratuar nga organizata përkatëse rajonale për menaxhimin e peshkimit në përputhje me rregullat dhe procedurat e kësaj organizate dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, Pala i refuzon kësaj anijeje hyrjen në portet e saj, duke pasur parasysh paragrafët 2 dhe 3, të nenit 4.

5. Pavarësisht paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni, një Palë mund t'i lejojë hyrjen në port një anijeje të përmendur në këta paragrafë në mënyrë ekskluzive për qëllim të inspektimit të saj dhe për të marrë masa të tjera të duhura në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, të cilat janë të paktën po aq të efektshme sa refuzimi i hyrjes në port për parandalimin, frenimin dhe eliminimin e peshkimit PPP dhe veprimtarive që lidhen me peshkimin të cilat e mbështesin këtë peshkim.

6. Nëse një anije e përmendur në paragrafin 4 ose 5 të këtij neni është në port për çfarëdo arsye, një Palë i refuzon kësaj anijeje përdorimin e portit

të saj për zbarkim, transbondim, paketim dhe përpunim të peshkut dhe shërbimeve të tjera portuale, duke përfshirë, ndër të tjera, rifurnizimin me lëndë djegëse dhe pajisje, mirëmbajtje dhe ankorim në dok. Në këto raste paragrafët 2 dhe 3, të nenit 11, zbatohen *mutatis mutandis*. Refuzimi i përdorimit të porteve bëhet në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

## Neni 10

**Forca madhore ose fatkeqësitë**

Asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk ndikon në hyrjen e anijeve në port në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për arsye të forcës madhore ose fatkeqësive, ose nuk e ndalon një shtet portual që të lejojë hyrjen në port të një anijeje në mënyrë ekskluzive për qëllim të dhënies së ndihmës për personat, anijet ose avionin në rrezik apo fatkeqësi.

## PJESA 3

## PËRDORIMI I PORTEVE

## Neni 11

**Përdorimi i porteve**

1. Një palë, kur një anije ka hyrë në një nga portet e saj, i refuzon kësaj anijeje, sipas ligjeve dhe rregullave dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, përfshirë këtë Marrëveshje, përdorimin e portit për zbarkimin, transbordimin, paketimin dhe përpunimin e peshkut që është zbarkuar më përpara dhe për shërbime të tjera portuale, duke përfshirë, ndër të tjera, rifurnizimin me lëndë djegëse dhe pajisje, mirëmbajtje dhe ankorim në dok nëse:

a) Pala konstaton që anija nuk ka autorizim të vlefshëm dhe të zbatueshëm për t'u përfshirë në peshkim ose veprimtari që lidhen me peshkimin të kërkuara nga shteti i flamurit;

b) Pala konstaton që anija nuk ka autorizim të vlefshëm dhe të zbatueshëm për t'u përfshirë në peshkim ose veprimtari që lidhen me peshkimin, të kërkuara nga shteti bregdetar në lidhje me zonat nën juridiksionin kombëtar të atij shteti;

c) Pala merr të dhëna të qarta që peshku në bord është marrë në shkelje të kërkesave të zbatueshme të një shteti bregdetar në lidhje me zonat nën juridiksionin kombëtar të atij shteti;

d) Shteti i flamurit nuk konfirmon brenda një periudhe të arsyeshme kohore, me kërkesë të



shtetit portual, që peshku në bord është marrë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të një organizate përkatëse rajonale për menaxhimin e peshkimit, duke pasur parasysh paragrafët 2 dhe 3, të nenit 4; ose

e) Pala ka shkaqe të arsyeshme të besojë që anija është përfshirë në peshkimin PPP ose veprimtari që lidhen me peshkimin, të cilat e mbështesin këtë peshkim, si edhe në mbështetje të një anijeje të përmendur në paragrafin 4, të nenit 9, përveç rasteve kur anija mund të provojë:

i) që ka vepruar në përputhje me masat përkatëse të konservimit dhe menaxhimit; ose

ii) që, në rastin e sigurimit të stafit, lëndës djegëse, mjeteve të peshkimit dhe furnizimeve të tjera në det, anija që është furnizuar, në kohën e furnizimit nuk ka qenë anije siç përcaktohet në paragrafin 4 të nenit 9.

2. Një Palë, pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, nuk i refuzon një anijeje të përmendur në atë paragraf përdorimin e shërbimeve portuale:

a) thelbësore për sigurinë ose shëndetin e ekipazhit ose sigurinë e anijes, nëse këto nevoja provohen si duhet; ose

b) për kthimin e anijes për skrap, sipas rastit.

3. Nëse një Palë refuzon përdorimin e porteve të saj sipas këtij neni, ajo njofton menjëherë për vendimin e saj shtetin e flamurit dhe, sipas rastit, shtetet përkatëse bregdetare, organizatat rajonale për menaxhimin e peshkimit dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare.

4. Një Palë tërheq refuzimin e përdorimit të portit të saj sipas paragrafit 1 të këtij neni në lidhje me një anije vetëm nëse ka prova të mjaftueshme që shkaqet për të cilat është refuzuar janë të papërshtatshme ose të gabuara ose që këto shkaqe nuk vlejnë më.

5. Nëse një Palë tërheq refuzimin e saj sipas paragrafit 4 të këtij neni, ajo njofton menjëherë ata për të cilët është bërë njoftimi sipas paragrafit 3 të këtij neni.

#### PJESA 4

### INSPEKTIMI DHE MASAT VIJUESE

#### Neni 12

### Nivelet dhe përparësitë për inspektim

1. Çdo Palë inspekton numrin e mjeteve të lundrimit të saj në port të nevojshëm për të arritur një nivel vjetor të inspektimeve të mjaftueshme për realizimin e objektivit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Palët synojnë të bien dakord për një numër minimal të inspektimeve të mjeteve të lundrimit nëpërmjet, sipas rastit, organizatave rajonale për menaxhimin e peshkimit, FAO-s ose tjetër.

3. Një Palë, në përcaktimin e mjeteve të lundrimit që do të inspektohen, i jep përparësi:

a) mjeteve të lundrimit të cilave u është refuzuar hyrja ose përdorimi i një porti në përputhje me këtë Marrëveshje;

b) kërkesave nga Palë të tjera të rëndësishme, shteteve ose organizatave rajonale për menaxhimin e peshkimit që mjete lundrimit të caktuara të inspektohen, sidomos nëse këto kërkesa mbështeten nga të dhëna për peshkim PPP ose veprimtari që lidhen me peshkimin, të cilat mbështesin këtë peshkim me anë të mjeteve të lundrimit në fjalë; dhe

c) mjeteve të tjera të lundrimit për të cilat ka arsye të qarta për të dyshuar që janë përfshirë në peshkim PPP ose veprimtari që lidhen me peshkimin të cilat e mbështesin këtë peshkim.

#### Neni 13

### Kryerja e inspektimeve

1. Çdo Palë sigurohet që inspektorët e saj të kryejnë funksionet e përcaktuara në aneksin B si standard minimal.

2. Çdo Palë, në kryerjen e inspektimeve në porte:

a) sigurohet që inspektimet të kryhen nga inspektorë të kualifikuar si duhet të autorizuar për këtë qëllim, duke pasur veçanërisht parasysh nenin 17;

b) sigurohet që, përpara një inspektimi, inspektorëve t'u kërkohet t'i paraqesin kapitenit të mjetit të lundrimit një dokument të duhur që i identifikon inspektorët si të tillë;

c) sigurohet që inspektorët të shqyrtojnë të gjitha fushat përkatëse të mjeteve të lundrimit, peshkun në bord, rjetat dhe çdo mjet tjetër peshkimi, pajisje dhe çdo dokument apo të dhënë në bord që është e rëndësishme për të verifikuar respektimin e masave përkatëse të konservimit dhe menaxhimit;

d) i kërkon kapitenit të mjetit të lundrimit që t'u japë inspektorëve të gjithë ndihmën dhe informacionin e nevojshëm dhe të paraqesë dokumentet dhe materialet e rëndësishme që mund të kërkohen ose kopje të noterizuara të tyre;



e) në rastin e marrëveshjeve të duhura me shtetin e flamurit të mjetit të lundrimit, fton atë shtet që të marrë pjesë në inspektim;

f) bën të gjitha përpjekjet e mundshme për të shmangur vonesat e mjetit të lundrimit për të minimizuar ndërhyrjen dhe vështirësitë, si edhe çdo prani të panevojshme të inspektorëve në bord dhe për të shmangur veprime që do të ndikonin negativisht në cilësinë e peshkut në bord;

g) bën të gjitha përpjekjet e mundshme për të lehtësuar komunikimin me kapitenin ose anëtarët e ekuipazhit të mjetit të lundrimit, përfshirë, nëse është e mundur dhe e nevojshme, rastet kur inspektori është i shoqëruar me një përkthyes;

h) sigurohet që inspektimet të kryhen në mënyrë të drejtë, transparente dhe jodiskriminuese dhe të mos përbëjnë ngacim të mjetit të lundrimit; dhe

i) të mos ndërhyjë në aftësinë e kapitenit, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, për të komunikuar me autoritetet e shtetit të flamurit.

#### Neni 14

##### **Rezultatet e inspektimeve**

Çdo Palë, si standard minimal, në një raport të shkruar të rezultateve të çdo inspektimi përfshin informacionin e paraqitur në aneksin C.

#### Neni 15

##### **Përcjellja e rezultateve të inspektimit**

Çdo Palë i përcjell rezultatet e çdo inspektimi të shteti i flamurit që mban mjeti i lundrimit të inspektuar dhe, sipas rastit:

a) Palëve dhe shteteve përkatëse, përfshirë:

i) atyre shteteve për të cilat ka të dhëna nëpërmjet inspektimit që mjeti i lundrimit është përfshirë në peshkim PPP ose veprimtari që lidhen me peshkimin të cilat e mbështesin këtë peshkim brenda ujërave në juridiksionin e tyre kombëtar; dhe

ii) shtetit, shtetësinë e të cilit e mban kapiteni i mjetit të lundrimit;

b) organizatave të duhura rajonale për menaxhimin e peshkimit; dhe

c) FAO-s dhe organizatave të tjera përkatëse ndërkombëtare.

#### Neni 16

##### **Shkëmbimi elektronik i informacionit**

1. Çdo Palë, për të lehtësuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, kur është e mundur, krijon një

mekanizëm komunikimi që lejon shkëmbimin e drejtpërdrejtë elektronik të informacionit, duke pasur parasysh kërkesat e duhura të konfidencialitetit.

2. Palët, në masën e mundshme dhe duke pasur parasysh kërkesat e duhura të konfidencialitetit, duhet të bashkëpunojnë për të krijuar një mekanizëm për ndarjen e informacionit, preferueshëm të koordinuar nga FAO-ja, në lidhje me nisma të tjera të rëndësishme shumëpalëshe dhe ndërqeveritare dhe për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit me bankat ekzistuese të të dhënave të rëndësishme për këtë Marrëveshje.

3. Çdo Palë cakton një autoritet që të veprojë si pikë kontakti për shkëmbimin e informacionit sipas kësaj Marrëveshjeje. Çdo Palë njofton FAO-n për autoritetin e caktuar.

4. Çdo Palë e trajton informacionin që do të përcillet nëpërmjet një mekanizmi të krijuar sipas paragrafit 1 të këtij neni në përputhje me aneksin D.

5. FAO-ja i kërkon organizatave të duhura rajonale për menaxhimin e peshkimit që të japin informacion në lidhje me masat ose vendimet që kanë miratuar dhe zbatuar të cilat lidhen me këtë Marrëveshje për integrimin e tyre, në masën e mundshme dhe duke pasur parasysh kërkesat e duhura të konfidencialitetit, në mekanizmin e ndarjes së informacionit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

#### Neni 17

##### **Trajnimi i inspektorëve**

Çdo Palë sigurohet që inspektorët e saj të trajnohen si duhet duke pasur parasysh udhëzimet për trajnimin e inspektorëve në aneksin E. Palët përpiqen të bashkëpunojnë në këtë drejtim.

#### Neni 18

##### **Veprimet e shtetit portual pas inspektimit**

1. Nëse, pas një inspektimi ka arsye të qarta për të besuar që një mjet lundrimi është përfshirë në peshkim PPP ose veprimtari që lidhen me peshkimin, të cilat mbështesin këtë peshkim, Pala inspektuese:

a) njofton menjëherë për konstatimet e saj shtetin e flamurit dhe, sipas rastit, shtetet përkatëse bregdetare, organizatat rajonale për menaxhimin e peshkimit dhe organizata të tjera ndërkombëtare dhe shtetin shtetësinë e të cilit mban kapiteni i mjetit të lundrimit; dhe



b) i refuzon mjetit të lundrimit përdorimin e portit të saj për zbarkim, transbordim, paketim dhe përpunim të peshqve të cilët nuk janë zbarkuar më përpara dhe për shërbime të tjera portuale, përfshirë, ndër të tjera, rifurnizimin me lëndë djegëse dhe mjete, mirëmbajtje dhe ankorim në dok, nëse këto veprime nuk janë kryer më përpara në lidhje me mjetin e lundrimit, në përputhje me këtë Marrëveshje, përfshirë nenin 4.

2. Një Palë, pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, nuk i refuzon një mjeti lundrimi të përmendur në atë paragraf përdorimin e shërbimeve portuale thelbësore për sigurinë ose shëndetin e ekuipazhit ose sigurinë e mjetit të lundrimit.

3. Asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk e pengon një Palë që të mos marrë masa në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, përveç atyre të specifikuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, përfshirë masat e kërkuara shprehimisht nga shteti i flamurit ose për të cilat ka dhënë pëlqimin.

#### Neni 19

#### **Informacioni mbi ankimimin në shtetin portual**

1. Një Palë vë informacionin e duhur në dispozicion të publikut dhe i jep këtë informacion, pas një kërke me shkrim, pronarit, operatorit, kapitenit ose përfaqësuesit të një mjeti lundrimi në lidhje me një ankimim të përcaktuar në përputhje me ligjet dhe rregullat e tij kombëtare për masat e shtetit portual të marra nga ajo Palë sipas nenit 9, 11, 13 ose 18, përfshirë informacionin që i përket shërbimeve publike ose institucioneve gjyqësore në dispozicion për këtë qëllim, si edhe informacion nëse ekziston e drejta për të kërkuar dëmshpërblim në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj kombëtare, në rast të humbjes ose dëmit të pësuar si pasojë e një veprimi të paligjshëm të pretenduar nga Pala.

2. Pala informon shtetin e flamurit, pronarin, operatorin, kapitenin ose përfaqësuesin, sipas rastit, për rezultatin e çdo ankimimi të tillë. Nëse Palët e tjera, shtetet ose organizatat ndërkombëtare kanë informacion për vendimin paraprak në përputhje me nenet 9, 11, 13 ose 18, Pala i informon për çdo ndryshim në vendimin e saj.

#### PJESA 5

#### ROLI I SHTETEVE TË FLAMURIT

#### Neni 20

#### **Roli i shteteve të flamurit**

1. Çdo Palë i kërkon mjeteve të lundrimit që kanë të drejtë të mbajnë flamurin e saj që të bashkëpunojnë me shtetin portual për inspektimet e kryera sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse një Palë ka arsye të qarta për të besuar se një mjet lundrimi me flamurin e saj është përfshirë në peshkim PPP ose veprimtari që lidhen me peshkimin të cilat mbështetin këtë peshkim dhe që kërkon të hyjë ose është në portin e një shteti tjetër, sipas rastit i kërkon atij shteti që të inspektojë mjetin e lundrimit ose të marrë masat në përputhje me këtë Marrëveshjeje.

3. Çdo Palë inkurajon mjetet e lundrimit që kanë të drejtë të mbajnë flamurin e saj të zbarkojnë, transbordojnë, paketojnë dhe përpunojnë peshkun dhe të përdorin shërbimet e tjera portuale, në porte të shteteve që veprojnë sipas ose në përputhje me këtë Marrëveshjeje. Palët inkurajohen të zhvillojnë, edhe nëpërmjet organizatave rajonale për menaxhimin e peshkimit dhe FAOs-s, procedura të drejta, transparente dhe jodiskriminuese për identifikimin e një shteti që mund të jetë duke vepruar sipas ose në përputhje me këtë Marrëveshjeje.

4. Nëse, pas një inspektimi të shtetit portual, pala e shtetit të flamurit merr një raport inspektimi që tregon se ka arsye të qarta për të menduar që një mjet lundrimi që mban flamurin e saj është përfshirë në peshkim PPP ose veprimtari që lidhen me peshkimin të cilat mbështetin këtë lloj peshkimi, ajo e njofton menjëherë dhe heton plotësisht për çështjen dhe, me të siguruar provat e mjaftueshme, merr masa ekzekutimi pa vonesë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e saj.

5. Çdo Palë, në cilësinë e saj si shtet i flamurit, u raporton palëve të tjera, shteteve portuale përkatëse dhe, sipas rastit, shteteve përkatëse, organizatave rajonale për menaxhimin e peshkimit dhe FAOs për masat e marra në lidhje me mjetin e lundrimit që mban flamurin e saj, i cili, si pasojë e masave të marra nga shteti portual në përputhje me këtë Marrëveshjeje, rezulton të jetë përfshirë në peshkim PPP ose veprimtari të lidhen me peshkimin, të cilat e mbështetin këtë peshkim.





6. Çdo Palë sigurohet që masat e zbatuara për mjetet e lundrimit, që mbajnë flamurin e saj, të jenë po aq të efektshme në parandalimin, pengimin dhe eliminimin e peshkimit PPP dhe veprimtarive që lidhen me peshkimin, të cilat mbështesin këtë peshkim sa masat që zbatohen për mjetet e lundrimit të përmendura në paragrafin 1, të nenit 3.

#### PJESA 6

### KËRKESAT E SHTETEVE NË ZHVILLIM

#### Neni 21

#### Kërkesat e shteteve në zhvillim

1. Palët i pranojnë plotësisht kërkesat e veçanta të shteteve Palë në zhvillim në lidhje me masat e shtetit portual në përputhje me këtë Marrëveshje. Palët për këtë qëllim, drejtpërdrejt ose përmes FAO-s, agjencive të tjera të specializuara të Kombeve të Bashkuara ose organizatave dhe organeve të duhura ndërkombëtare, përfshirë organizatat rajonale për menaxhimin e peshkimit, i ndihmojnë shtetet Palë në zhvillim, ndër të tjera, për të:

a) rritur aftësinë e tyre, sidomos të shteteve më pak të zhvilluara mes tyre dhe shteteve të vogla ishullore në zhvillim, që të përgatisin bazën ligjore dhe kapacitet për zbatimin e masave të efektshme të shtetit portual;

b) lehtësuar pjesëmarrjen e tyre në organizata ndërkombëtare që promovojnë zhvillimin e efektshëm dhe zbatimin e masave të shtetit portual; dhe

c) lehtësuar asistencën teknike për forcimin e zhvillimit dhe zbatimin e masave të shtetit portual prej tyre, në koordinim me mekanizmat e duhur ndërkombëtarë.

2. Palët i japin vëmendjen e duhur kërkesave të veçanta të shtetit Palë portual në zhvillim sidomos më pak të zhvilluar mes tyre dhe shteteve të vogla ishullore në zhvillim për të siguruar që barra disproporcionale që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje të mos i transferohet atyre drejtpërdrejt apo jo. Në rastet kur tregohet që transferimi i barrës ka qenë disproporcional, Palët bashkëpunojnë për të lehtësuar zbatimin e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje nga shtetet Palë në zhvillim.

3. Palët, drejtpërdrejt ose përmes FAO-s, vlerësojnë kërkesat e veçanta të shteteve Palë në

zhvillim në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

4. Palët bashkëpunojnë për të krijuar mekanizmat e duhur të financimit për të ndihmuar shtetet në zhvillim për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Këta mekanizma, ndër të tjera, orientohen në mënyrë specifike, për:

a) zhvillimin e masave kombëtare dhe ndërkombëtare të shtetit portual;

b) zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve përfshirë kapaciteteve për monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen dhe për trajnimin në nivel kombëtar dhe rajonal të menaxherëve të portit, inspektorëve dhe stafit zbatues dhe ligjor;

c) monitorimin, kontrollin, mbikëqyrjen dhe veprimtaritë e respektimit në lidhje me masat e shtetit portual, përfshirë aksesin në teknologji dhe pajisje; dhe

d) ndihmën për shtetet palë në zhvillim me kosto të përfshira në çdo proces për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që rezultojnë nga masat që kanë marrë sipas kësaj Marrëveshjeje.

5. Bashkëpunimi me dhe mes shteteve Palë në zhvillim për qëllimet e përcaktuara në këtë nen mund të përfshijë ofrimin e asistencës teknike dhe financiare përmes rrugëve dypalëshe, shumëpalëshe dhe rajonale, përfshirë bashkëpunimin jug-jug.

6. Palët krijojnë një grup pune *ad hoc* për të raportuar rregullisht dhe për t'i bërë rekomandime Palëve për krijimin e një mekanizmi financimi përfshirë një skemë për kontribute, identifikimin dhe mobilizimin e fondeve, zhvillimin e kritereve dhe procedurave për të orientuar zbatimin dhe ecurinë në zbatimin e mekanizmave të financimit. Përveç konsideratave të parashikuara në këtë nen, grupi i posaçëm i punës merr parasysh, ndër të tjera:

a) vlerësimin e nevojave të shteteve Palë në zhvillim, sidomos më pak të zhvilluar mes tyre dhe shteteve të vogla ishullore në zhvillim;

b) disponueshmërinë dhe disbursimin në kohë të fondeve;

c) transparencën e vendimmarrjes dhe proceseve të menaxhimit në lidhje me mbledhjen e fondeve dhe alokimeve; dhe

d) përgjegjshmërinë e shtetit palë në zhvillim për përdorimin e miratuar të fondeve.

Palët marrin parasysh raportet dhe rekomandimet e grupit të punës *ad hoc* dhe marrin masat e duhura.



PJESA 7  
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 22

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim**

1. Secila Palë mund të kërkojë konsultime me çdo Palë ose Palët e tjera për çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, me qëllim që të arrihet një zgjidhje e kënaqshme reciproke sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet nëpërmjet këtyre konsultimeve brenda një periudhe kohore të arsyeshme, Palët në fjalë konsultohen mes tyre sa më shpejt që të jetë e mundur me qëllim që mosmarrëveshja të zgjidhet me negociim, kërkim, ndërmjetësim, pajtim, arbitrazh, zgjidhje gjyqësore ose mjete të tjera paqësore që ato zgjedhin.

3. Çdo mosmarrëveshje e kësaj natyre, që nuk zgjidhet në këtë mënyrë, me pëlqimin e palëve në mosmarrëveshje, referohet për zgjidhje në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, Tribunalin Ndërkombëtar për të Drejtën e Detit ose në arbitrazh. Në rast të mosarritjes së marrëveshjes së referuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, Tribunalin Ndërkombëtar të së Drejtës së Detit ose arbitrazh, Palët vazhdojnë të konsultohen dhe të bashkëpunojnë për të arritur zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me rregullat e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me konservimin e burimeve të gjalla detare.

PJESA 8  
SHTETET JO PALË

Neni 23

**Shtetet jo Palë të kësaj Marrëveshjeje**

1. Palët inkurajojnë shtetet jo Palë të kësaj Marrëveshjeje që të bëhen Palë të saj dhe/ose të miratojnë ligjet dhe rregulloret dhe të zbatojnë masat në përputhje me dispozitat e saj.

2. Palët marrin masa të drejta, jodiskriminuese dhe transparente në përputhje me këtë Marrëveshje dhe të drejtë tjetër të zbatueshme ndërkombëtare për të frenuar veprimtaritë e shteteve jo Palë që rrezikojnë zbatimin e efektshëm të kësaj Marrëveshjeje.

PJESA 9  
MONITORIMI, RISHIKIMI DHE VLERËSIMI

Neni 24

**Monitorimi, rishikimi dhe vlerësimi**

1. Palët, në kuadër të FAO-s dhe organeve përkatëse të saj, sigurojnë monitorimin dhe rishikimin e rregullt dhe sistematik të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, si edhe vlerësimin e progresit të bërë për arritjen e objektivave të saj.

2. Katër vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, FAO-ja thërret një takim të Palëve për të rishikuar dhe vlerësuar efektshmërinë e kësaj Marrëveshjeje në arritjen e objektivit të saj. Palët vendosin për takime të mëtejshme sipas nevojës.

PJESA 10  
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 25

**Nënshkrimi**

Kjo Marrëveshje është e hapur për nënshkrim në FAO nga dita e njëzet e dytë e nëntorit 2009 deri në ditën e njëzet e një të nëntorit 2010 nga të gjitha shtetet dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik.

Neni 26

**Ratifikimi, pranimi ose miratimi**

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga palët nënshkruese.

2. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen te Depozitari.

Neni 27

**Aderimi**

1. Pas periudhës gjatë së cilës kjo Marrëveshje është e hapur për nënshkrim, Marrëveshja hapet për aderim nga çdo shtet ose organizatë rajonale për integrimin ekonomik.

2. Instrumentet e aderimit depozitohen te Depozitari.

Neni 28

**Pjesëmarrja nga organizatat rajonale të integritit ekonomik**

1. Në rastet kur një organizatë rajonale për integrimin ekonomik, pra një organizatë ndërkombëtare e përmendur në aneksin IX, neni 1 i Konventës, nuk ka kompetencë mbi të gjitha



çështjet që rregullon kjo Marrëveshje, aneksi IX i Konventës zbatohet *mutatis mutandis* për pjesëmarrjen nga kjo organizatë rajonale e integritit ekonomik në këtë Marrëveshje, por dispozitat e mëposhtme të atij aneksi nuk zbatohen:

- a) neni 2, fjalia e parë; dhe
- b) neni 3, paragrafi i parë.

2. Në rastet kur një organizatë rajonale për integritimin ekonomik, pra një organizatë ndërkombëtare e përmendur në aneksin IX, neni 1 i Konventës ka kompetencë mbi të gjitha çështjet që rregullon kjo Marrëveshje, dispozitat e mëposhtme zbatohen për pjesëmarrjen e organizatës rajonale të integritit ekonomik në këtë Marrëveshje:

a) në kohën e nënshkrimit ose aderimit, kjo organizatë bën një deklaratë ku thuhet:

i) që ka kompetencë mbi të gjitha çështjet që rregullon kjo Marrëveshje;

ii) që, për këtë arsye, shtetet anëtare të saj nuk bëhen shtete Palë përveçse në lidhje me territoret e tyre për të cilat organizata nuk ka përgjegjësi; dhe

iii) që pranon të drejtat dhe detyrimet e shteteve sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) pjesëmarrja e kësaj organizate në asnjë rast nuk delegon ndonjë nga këto të drejta sipas Marrëveshjes te shtetet anëtare të organizatës;

c) në rast të konfliktit ndërmjet detyrimeve të kësaj organizate sipas kësaj Marrëveshjeje dhe detyrimeve të saj sipas Marrëveshjes që krijon organizatën ose çdo akt në lidhje me atë, detyrimet e kësaj Marrëveshjeje do të kenë epërsi.

Neni 29

### Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi tri ditë pas datës së depozitimit te depozitari i instrumentit të njëzetepesë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, në përputhje me nenet 26 ose 27.

2. Për çdo Palë nënshkruese që ratifikon, pranon ose miraton këtë Marrëveshje pas hyrjes në fuqi, kjo Marrëveshje hyn në fuqi tridhjetë ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

3. Për çdo shtet ose organizatë rajonale të integritit ekonomik që aderon në këtë Marrëveshje, kjo Marrëveshje hyn në fuqi tridhjetë ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të saj të aderimit.

4. Për qëllime të këtij neni, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale integriti ekonomik, nuk do të llogaritet si shtesë për ato që janë depozituar nga shtetet e tij anëtare.

Neni 30

### Rezerva dhe përjashtime

Për këtë Marrëveshje nuk mund të bëhen rezerva ose përjashtime.

Neni 31

### Deklarata dhe pohime

Neni 30 nuk e pengon një shtet ose organizatë rajonale të integritit ekonomik, kur nënshkruan, ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë Marrëveshje, që të bëjë një deklaratë ose pohim, sido që të quhet, me synim, ndër të tjera, harmonizimin e ligjeve dhe rregulloreve të saj me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, nëse kjo deklaratë ose ky pohim nuk synojnë të përjashtojnë ose të modifikojnë ndikimin ligjor të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje në zbatimin e tyre për atë shtet ose organizatë rajonale të integritit ekonomik.

Neni 32

### Zbatimi i përkohshëm

1. Kjo Marrëveshje zbatohet përkohësisht nga shtetet ose organizatat rajonale të integritit ekonomik që pranojnë zbatimin e saj të përkohshëm duke njoftuar depozitarin me shkrim. Ky zbatim i përkohshëm hyn në fuqi nga data e marrjes së njoftimit.

2. Zbatimi i përkohshëm nga një shtet ose organizatë rajonale e integritit ekonomik përfundon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje për atë shtet ose organizatë rajonale të integritit ekonomik ose me njoftimin me shkrim nga ai shtet apo organizatë rajonale integriti ekonomik te Depozitari për synimin e tij për të përfunduar zbatimin e përkohshëm.

Neni 33

### Ndryshime

1. Çdo Palë mund të propozojë ndryshime në këtë Marrëveshje pas mbarimit të një periudhe dyvjeçare nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.



2. Çdo ndryshim i propozuar për këtë Marrëveshje i dërgohet me anë të një komunikimi me shkrim Depozitari të bashku me një kërkesë për thirrjen e një takimi të palëve për ta marrë parasysh. Depozitari i qarkullon të gjitha Palëve këtë informacion, si edhe përgjigjen për kërkesat e marra nga Palët. Depozitari, nëse gjysma e Palëve nuk kundërshtojnë kërkesën gjashtë muaj nga data e qarkullimit të komunikimit, thërret një mbledhje të Palëve që të konsiderojnë ndryshimin e propozuar.

3. Sipas nenit 34, çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje miratohet me konsensusin e Palëve të pranishme në takim ku është propozuar për miratim.

4. Sipas nenit 34, çdo ndryshim i miratuar nga takimi i Palëve hyn në fuqi mes Palëve që e kanë ratifikuar, pranuar ose miratuar në ditën e nëntëdhjetë pas depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit me dy të tretat e Palëve të kësaj Marrëveshjeje bazuar në numrin e Palëve në datën e miratimit të ndryshimit. Më pas ndryshimi hyn në fuqi për çdo Palë tjetër ditën e nëntëdhjetë pas depozitimit nga ajo Palë të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit të ndryshimit.

5. Për qëllime të këtij neni, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale integrimi ekonomik, nuk do të llogaritet si shtesë për ato që janë depozituar nga shtetet e tij anëtare.

#### Neni 34 Anekset

1. Anekset janë pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje dhe një referencë për këtë Marrëveshje përbën referencë për anekset.

2. Ndryshimi i një aneksi të kësaj Marrëveshjeje mund të miratohet me dy të tretat e Palëve të kësaj Marrëveshjeje të pranishme në një takim ku konsiderohet ndryshimi i propozuar për aneksin. Megjithatë, do të bëhet çdo përpjekje për të arritur me konsensus një marrëveshje për një ndryshim të një aneksi. Një ndryshim i një aneksi përfshihet në këtë Marrëveshje dhe hyn në fuqi për ato Palë që kanë shprehur pranimin e tyre nga data ku Depozitari merr njoftimin e pranimit nga dy të tretat e Palëve të kësaj Marrëveshjeje, bazuar në numrin e Palëve në datën e miratimit të ndryshimit.

Më pas ndryshimi hyn në fuqi për çdo Palë që mbetet pasi Depozitari merr pranimin e saj.

#### Neni 35 Tërheqjet

Secila Palë mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje në çdo kohë pasi të kalojë një vit nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes në lidhje me atë Palë, duke njoftuar me shkrim Depozitarin për këtë tërheqje. Tërheqja hyn në fuqi një vit pas marrjes së njoftimit të tërheqjes nga Depozitari.

#### Neni 36 Depozitari

Zëvendës drejtori i FAO-s është Depozitari i kësaj Marrëveshjeje. Depozitari:

a) i përcjell kopje të noterizuara të kësaj Marrëveshjeje çdo pale nënshkruese të saj;

b) regjistron këtë Marrëveshje, me hyrjen e saj në fuqi, te Sekretariati i Kombeve të Bashkuara, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara;

c) njofton menjëherë secilën palë nënshkruese dhe palë të kësaj Marrëveshjeje, për:

i) të gjitha nënshkrimet dhe instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit dhe anëtarësimit të depozituara sipas neneve 25, 26 dhe 27;

ii) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 29;

iii) të gjitha propozimet për ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje dhe miratimin e tyre dhe hyrjen në fuqi në përputhje me nenin 33;

iv) të gjitha propozimet për ndryshimin e anekseve dhe miratimin e tyre dhe hyrjen në fuqi në përputhje me nenin 34; dhe

v) të gjitha tërheqjet nga kjo Marrëveshje në përputhje me nenin 35.

#### Neni 37 Tekste autentike

Tekstet e kësaj Marrëveshjeje në gjuhën arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle janë njësoj autentike.

Në dëshmi të kësaj, të Plotfuqishmit e nënshkruar, të autorizuar përkatësisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në Romë, ditën e njëzet e dytë të nëntorit, 2009.



ANEKSI A  
INFORMACION QË DUHET TË JEPET PARAPRAKISHT NGA ANIJET  
QË KËRKOJNË TË HYJNË NË PORT

1. Porti i thirrjes i destinuar								
2. Shteti portual								
3. Data dhe ora e parashikuar e mbërritjes								
4. Qëllimi/qëllimet								
5. Porti dhe data e fundit e thirrjes portuale								
6. Emri i anijes								
7. Shteti i flamurit								
8. Lloji i mjetit								
9. Kodi Ndërkombëtar i Komunikimit me Radio								
10. Informacioni i kontaktit të anijes								
11. Pronari/pronarët e anijes								
12. Certifikata e ID të regjistrimit								
13. IMO ID i anijes, nëse ka								
14. ID e jashtme, nëse ka								
15. RFMO ID, nëse ka								
16. VMS	Jo	Po: Kombëtar	Po: RFMO (të)	Lloji:				
17. Dimensionet e anijes	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia					
18. Emri dhe shtetësia e kapitenit të anijes								
19. Autorizimi/autorizimet përkatëse të peshkimit								
Identifikues	Lëshuar nga	Vlefshmëria	Zona/t e peshkimit	Speciet	Mjete peshkimi			
20. Autorizimi/autorizimet përkatëse të transbordimit								
Identifikues	Lëshuar nga	Vlefshmëria						
Identifikues	Lëshuar nga	Vlefshmëria						
21. Informacion transbordimi në lidhje me mjetet e lundrimit dhënëse								
Datë	Vendndodhja	Emri	Shteti i flamurit	Numri ID	Speciet	Forma e produktit	Zona e zënies së peshkut	Sasia
22. E gjithë zënia në bord							23. Zënia për t'u zbarkuar	
Speciet	Forma e produktit	Zona e zënies së peshkut	Sasia	Sasia				

ANEKSI B  
PROCEDURAT E INSPEKTIMIT TË  
SHTETIT PORTUAL

Inspektorët:

a) verifikojnë, në masën e mundshme, që dokumenti i identifikimit të anijes dhe informacioni në lidhje me pronarin e mjetit të lundrimit është i vërtetë, i plotë dhe i saktë, përfshirë kontaktet e duhura me shtetin e flamurit ose të dhënat ndërkombëtare të mjetit të lundrimit, nëse është e nevojshme;

b) verifikojnë flamurin e mjetit të lundrimit dhe shenjat dalluese (p.sh.: emri, numri i jashtëm i regjistrimit, numri i identifikimit të anijes sipas Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), kodi ndërkombëtar i komunikimit me radio dhe shenja të tjera, dimensionet kryesore) që të jenë në përputhje me informacionin që përmban dokumentacionin;

c) verifikojnë, në masën e mundshme, që autorizimet për peshkim dhe veprimtari që lidhen me peshkimin janë të vërteta, të plota, të sakta dhe



në përputhje me informacionin e dhënë sipas aneksit A;

d) rishikojnë të gjithë dokumentacionin dhe të dhënat e rëndësishme në bord, përfshirë, në masën e mundshme, ato që janë në format elektronik dhe të dhënat e sistemit të monitorimit të mjeteve të lundrimit (VMS) nga shteti i flamurit ose organizata përkatëse rajonale për menaxhimin e peshkimit (RFMO-të). Dokumentacioni i rëndësishëm mund të përfshijë ditarë udhëtimi, zënien, transbordimin dhe dokumentet e tregtisë, listat e ekuipazhit, planet dhe skicat e ngarkesës, përshkrimet e mbajtëseve të peshkut dhe dokumente të kërkuara sipas Konventës për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër;

e) ekzaminojnë, në masën e mundshme, të gjitha mjetet e duhura të peshkimit në bord, përfshirë çdo mjet peshkimi të vendosur larg syrit, si edhe pajisjet përkatëse dhe në masën e mundshme, verifikojnë që ato të jenë në përputhje me kushtet e autorizimeve. Mjetet e peshkimit, në masën e mundshme, gjithashtu do të kontrollohen që veçoritë si madhësia e rrjetës dhe thurjes, pajisjet dhe pjesët shtesë, dimensionet dhe konfiguracioni i rrjetës, kurtheve, dragës, madhësia e grepit dhe numrat të jenë në përputhje me rregullat e zbatueshme dhe shenjat dalluese t'i korrespondojnë atyre të autorizuara për mjetin e lundrimit;

f) përcaktojnë, në masën e mundshme, nëse peshku në bord është vjelë në përputhje me autorizimet e zbatueshme;

g) ekzaminojnë peshkun, duke marrë kampionë, për të përcaktuar sasinë dhe përbërjen. Në këtë mënyrë, inspektorët mund të hapin kontejnerët ku është paketuar peshku paraprakisht dhe të zhvendosin zënien ose kontejnerët për t'u siguruar që të ruhet tërësia e peshkut. Ky ekzaminim mund të përfshijë inspektimin e llojit të produktit dhe përcaktimin e peshës nominale;

h) vlerësojnë nëse ka prova për të besuar që një mjet lundrimi është përfshirë në peshkim PPP ose veprimtari që lidhen me peshkimin të cilat e mbështesin këtë peshkim;

i) i japin kapitenit të mjetit të lundrimit raportin që përmban rezultatin e inspektimit, përfshirë masat e mundshme që mund të merren, i cili duhet të nënshkruhet nga inspektori dhe kapiteni. Firma e kapitenit në raport shërben vetëm si konfirmim që ka marrë një kopje të raportit. Kapitenit i jepet mundësia që të shtojë komente ose kundërshtime për raportin, dhe sipas rastit, të kontaktojë autoritetet përkatëse të shtetit të flamurit sidomos nëse kapiteni ka vështirësi të mëdha për të kuptuar përmbajtjen e raportit. Një kopje e raportit i jepet kapitenit; dhe

j) sigurojnë kur është e nevojshme dhe e mundshme përkthimin e dokumentacionit të duhur.

### ANEKSI C RAPORTI PËR REZULTATET E INSPEKTIMIT

1. Raport inspektimi nr.		2. Shteti portual	
3. Autoriteti i inspektimit			
4. Emri i inspektorit kryesor		ID	
5. Porti i inspektimit			
6. Fillimi i inspektimit		VVVV	MM DD HH
7. Përfundimi i inspektimit		VVVV	MM DD HH
8. Njoftimi paraprak i marrë		Po	Jo
9. Qëllimi/qëllimet	LAN	TRX	PRO TJE (specifiko)
10. Porti dhe shteti dhe data e fundit e thirrjes portuale		VVVV	MM DD
11. Emri i anijes			
12. Shteti i flamurit			
13. Lloji i mjetit			
14. Kodi Ndërkombëtar i Komunikimit me Radio			
15. Certifikata e ID të regjistrimit			
16. IMO ID i anijes, nëse ka			
17. ID e jashtme, nëse ka			
18. Porti i regjistrimit			



19. Pronari/pronarët e anijes						
20. Pronari/pronarët përfitues i/të anijes, nëse janë të ndryshëm nga pronari i anijes						
21. Operatori/operatorët i/e anijes, nëse janë të ndryshëm nga pronari i anijes						
22. Emri dhe shtetësia e kapitenit të anijes						
23. Emri dhe shtetësia e kapitenit të peshkimit						
24. Agjenti i anijes						
25. VMS	Jo	Po: Kombëtar	Po: RFMO-të	Lloji:		
26. Statusi në zonat RFMO, ku është kryer peshkimi ose veprimtari peshkimi, përfshirë listat e mjeteve të peshkimit PPP						
Identifikuesi i mjetit të lundrimit	RFMO	Statusi i shtetit të flamurit	Anije në listën e anijeve të autorizuar	Anije në listën e anijeve PPP		
27. Autorizimi/autorizimet përkatëse të peshkimit						
Identifikues	Lëshuar nga	Vlefshmëria	Zona/t e peshkimit	Speciet	Mjete peshkimi	
28. Autorizimi/autorizimet përkatëse të transbordimit						
Identifikues		Lëshuar nga		Vlefshmëria		
Identifikues		Lëshuar nga		Vlefshmëria		
29. Informacion transbordimi në lidhje me mjetet e lundrimit dhënëse						
Emri	Shteti i flamurit	ID nr.	Speciet	Forma e produktit	Zona/t e zënies	Sasia
30. Vlerësimi i zënies (sasisë) së zbarkuar						
Speciet	Forma e produktit	Zona/t e zënies	Sasia e deklaruar	Sasia e zbarkuar	Diferenca ndërmjet sasisë së deklaruar dhe sasisë së përcaktuar, nëse ka	
31. Zënia e mbajtur në bord (sasia)						
Speciet	Forma e produktit	Zona/t e zënies	Sasia e deklaruar	Sasia e zbarkuar	Diferenca ndërmjet sasisë së deklaruar dhe sasisë së përcaktuar, nëse ka	
32. Analizimi i ditari të udhëtimit dhe dokumentacioni tjetër			Po	Jo	Komente	
33. Respektimi i skemës/skemave të zbatueshme të dokumentacionit të zënies			Po	Jo	Komente	
34. Respektimi i skemës/skemave të zbatueshme të informacionit tregtar			Po	Jo	Komente	
35. Lloji i mjeteve të peshkimit të përdorura						
36. Mjetet e peshkimit të përdorura sipas paragrafit e) e aneksit B		Po	Jo	Komente		
37. Konstatimet nga inspektori/inspektorët						
38. Shkelja/shkeljet e dukshme të vëna re përfshirë referencën për instrumentet e duhura ligjore						



39. Komete nga kapiteni
40. Masat e marra
41. Firma e kapitenit
42. Firma e inspektorit

#### ANEKSI D SISTEMET E INFORMACIONIT PËR MASAT E SHTETIT PORTUAL

Në zbatim të kësaj Marrëveshje, çdo palë:

a) synon të vendosë komunikim të kompjuterizuar sipas nenit 16;

b) krijon, në masën e mundshme, faqe interneti për të publikuar listën e porteve të caktuara sipas nenit 7 dhe veprimeve të marra në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Marrëveshjeje;

c) identifikon, në masën më të madhe të mundshme, çdo raport inspektimi me një numër unik reference që fillon me kod 3-alpha të shtetit portual dhe identifikimin e agjencisë lëshuese;

d) përdor, në masën e mundshme, sistemin ndërkombëtar të kodimit më poshtë në anekset A dhe C dhe përkthen çdo sistem tjetër kodimi në sistemin ndërkombëtar.

vendi/vendet ISO-3166 3-alpha kodi i shtetit;

speciet: kodi ASFIS 3-alpha (njohur si FAO 3-kodi alfa);

llojet e anijes: kodi ISSCFV (njohur si FAO kodi alfa);

llojet e mjeteve të peshkimit: kodi ISSCFG (njohur si FAO kodi alfa).

#### ANEKSI E UDHËZIME PËR TRAJNIMIN E INSPEKTORËVE

Elementet e një programi trajnimi për inspektorët e shtetit portual duhet të përfshijnë të paktën fushat e mëposhtme:

1. Etika;

2. Çështje të shëndetit dhe sigurisë;

3. Legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme kombëtare, fushat e kompetencës dhe masat e konservimit dhe menaxhimit të RFMO-ve përkatëse dhe të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme;

4. Mbledhjen, vlerësimin dhe ruajtjen e të dhënave;

5. Procedurat të inspektimit të përgjithshëm si shkrimi i raporteve dhe teknikat e intervistimit;

6. Analizimin e informacionit, si ditarin e udhëtimit, dokumentacionin elektronik dhe historikun e mjetit të lundrimit (emri, pronësia dhe shteti i flamurit), të kërkuara për vlefshmërinë e informacionit të dhënë nga kapiteni i mjetit të lundrimit;

7. Hipjen në anije dhe inspektimin, përfshirë inspektimet e kryera dhe llogaritjen e vëllimeve të mbajtjes së mjeteve të lundrimit;

8. Verifikimin dhe vlefshmërinë e informacionit në lidhje me zbarkimin, transbordimin, përpunimin dhe peshkun që mbetet në bord, përfshirë përdorimin e faktorëve të ruajtjes për specie dhe produkte të ndryshme;

9. Identifikimin e specieve të peshkut dhe matjes së gjatësisë dhe parametrave të tjera biologjikë;

10. Identifikimin e mjeteve të lundrimit dhe të peshkimit dhe teknikeve për inspektimin dhe matjet e mjeteve të peshkimit;

11. Pajisjet dhe funksionimin e VMS-së dhe sistemeve të tjera elektronike të gjurmimit; dhe

12. Masat që duhet të merren pas një inspektimi.

Kopje origjinale e certifikuar e variantit anglisht të Marrëveshjes për Masat e Shtetit Portual për të Parandaluar, Frenuar dhe Eliminuar Peshkimin e Paligjshëm, të Paraportuar dhe të Parregulluar, e cila është miratuar më 22 nëntor 2009, në sesionin e tridhjetë e gjashtë të Konferencës së FAO-s. Në përputhje me dispozitat e paragrafit 7, të nenit XIV, të Kushtetutës së FAO-s, ky dokument është certifikuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës dhe Kryesuesi i Konferencës.

Jacques Diouf Kathleen Merrigan

Drejtor i Përgjithshëm Kryesues i Konferencës

Organizata e Kombeve të Bashkuara  
për Ushqim dhe Bujqësi





**LIGJ**  
**Nr. 11/2017**

**PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT  
TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
BASHKIMIT EUROPIAN PËR  
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË NË PROGRAMIN  
E DREJTËSISË SË BE-SË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së BE-së, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.2.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10009, datë 15.2.2017,  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
DHE BASHKIMIT EUROPIAN PËR  
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E  
DREJTËSISË TË BE-së**

Republika e Shqipërisë, më poshtë e referuar si Shqipëria,

nga njëra anë, dhe

Komisioni Europian, në vijim i referuar si “Komisioni”, në emër të Bashkimit Europian, nga ana tjetër,

Duke pasur parasysh se:

1. Marrëveshja kuadër ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian përcakton parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në

programet e BE-së, u miraturar më 22 nëntor të vitit 2004 dhe hyri në fuqi më 11 korrik 2005<sup>2</sup> (më poshtë e referuar si “Marrëveshja kuadër”), duke lejuar Komisionin dhe autoritetet kompetente të Shqipërisë që të përcaktojnë termat dhe kushtet specifike, përfshirë kontributin financiar, në lidhje me këtë pjesëmarrje në çdo program të veçantë.

2. Programi i Drejtësisë është themeluar me Rregulloren (BE) nr. 1382/2013, të Parlamentit Europian dhe Këshillit, të 17 dhjetorit 2013<sup>3</sup>,

**KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:**

**Neni 1**

**Programi**

Shqipëria do të marrë pjesë në programin e Drejtësisë (më poshtë i referuar si “Programi”), në pajtim me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër dhe sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në nenet 2–6 e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

**Neni 2**

**Termet dhe kushtet në lidhje me pjesëmarrjen në “program”**

1. Shqipëria do të marrë pjesë në aktivitetet e Programit në përputhje me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet siç përcaktohen në Rregulloren (BE) nr. 1382/2013, Shqipëria do të marrë pjesë në aktivitetet e Programit që lidhen me objektivat e mëposhtëm, të përcaktuar në nenin 4 të Rregullores:

a) për të lehtësuar dhe mbështetur bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile dhe penale;

b) për të mbështetur dhe nxitur trajnimin gjyqësor, duke përfshirë trajnimin gjuhësor për teminologjinë juridike, me qëllim nxitjen e një kulture të përbashkët juridike dhe gjyqësore;

c) për të lehtësuar aksesin efektiv në drejtësi për të gjithë, përfshirë nxitjen dhe mbështetjen e të drejtave të viktimave të krimit, duke respektuar në të njëjtën kohë të drejtat e mbrojtjes.

2. Termet dhe kushtet e zbatueshëm për paraqitjen, vlerësimin dhe përzgjedhjen e kërkesave nga institucionet, organizatat dhe individët e pranueshëm të Shqipërisë do të jenë të njëjta me ato që zbatohen për institucionet, organizatat dhe

<sup>2</sup> OJ L 192, 22.7.2005, f. 2

<sup>3</sup> OJ L 354, 28.12.2013, f. 73



individët e shteteve anëtare që kanë detyrimin ligjor sipas Rregullores (BE) nr. 1382/2013.

3. Për të marrë pjesë në Program, Shqipëria do të paguajë çdo vit një kontribut financiar për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit European në përputhje me nenin 3 më poshtë.

4. Përfaqësuesit e Shqipërisë do të marrin pjesë, si vëzhgues, në komunitetin e menaxhimit përgjegjës për monitorimin e programit.

5. Shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit të kryera nga përfaqësues të Shqipërisë do të mbulohen sipas rregullave të përcaktuara në shtojcën I, neni 2.

6. Një nga gjuhët zyrtare të BE-së do të përdoret për procedurat në lidhje me kërkesat, kontratat dhe raportet, si dhe për aspekte të tjera administrative të Programit.

Neni 3

#### **Kontributi financiar**

Rregullat që drejtojnë kontributin financiar të Shqipërisë janë përcaktuar në shtojcën I.

Neni 4

#### **Raportimi dhe vlerësimi**

Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe Gjykatës së Audituesve të Bashkimit European në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e Programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program do të monitorohet vazhdimisht mbi bazë partneriteti, duke përfshirë Komisionin dhe Shqipërinë.

Shqipëria i paraqet Komisionit raporte përkatëse dhe merr pjesë në aktivitete të tjera specifike të parashikuara nga BE-ja në këtë kontekst.

Raportimi dhe vlerësimi do të kryhen sipas rregullave të përcaktuara në shtojcën II.

Neni 5

#### **Dispozita të fundit**

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të zbatohet për kohëzgjatjen e programit ose deri në hyrjen e Shqipërisë në Bashkimin European, nëse kjo ndodh para përfundimit të Programit.

2. Projektet dhe aktivitetet e papërfunduara në momentin e përfundimit do të vazhdojnë deri në përmbushjen e tyre sipas kushteve të caktuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi, si dhe marrëveshjeve kontraktuale që zbatohen për këto projekte dhe aktivitete dhe dispozitat e shtojcës II.

3. Shtojcat përbëjnë pjesë integrale të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

4. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të palëve.

5. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën 1 janar 2017.

Bërë në Bruksel, në datën 28 shtator 2016, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

**Ylli Manjani**

Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë

PËR KOMISIONIN EUROPIAN

NË EMËR TË BASHKIMIT EUROPIAN

**Vëra Jourová**

Anëtar i Komisionit për Drejtësinë, Konsumatorët dhe Barazinë Gjinore

#### **SHTOJCA 1**

#### **RREGULLAT QË DREJTOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E DREJTËSISË**

1. Kontributi financiar që duhet të paguhet nga Shqipëria në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit European për të marrë pjesë në bashkëpunimin gjyqësor, trajnimin gjyqësor dhe aksesin në linjat e drejtësisë të Programit, do të jetë si më poshtë:

34 061 euro për vitin 2016;  
35 674 euro për vitin 2017;  
37 260 euro për vitin 2018;  
38 974 euro për vitin 2019;  
40 662 euro për vitin 2020.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit të kryera nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për qëllim të pjesëmarrjes si vëzhgues në punën e komitetit të përmendur në nenin 11 të Rregullores (BE) nr. 1382/2013, për miratimin e Programit apo takime të tjera që lidhen me zbatimin e Programit rimburohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë, si dhe në përputhje me procedurat aktualisht në fuqi për përfaqësues të shteteve anëtare të Bashkimit European.

3. Rregullorja financiare e zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit European do të zbatohet për menaxhimin e kontributit të Shqipërisë.



4. Pas nënshkrimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe në fillim të çdo viti pasues financiar, Komisioni i dërgon Shqipërisë një kërkesë për fonde që përputhet me kontributin e saj në shpenzimet e mbuluara nga ky Memorandum Mirëkuptimi.

5. Ky kontribut paguhet në euro në një llogari bankare të Komisionit të caktuar në euro.

6. Shqipëria do të paguajë kontributin e saj financiar për shpenzimet vjetore në pajtim me kërkesën për fonde jo më vonë se tre muaj pas datës së thirrjes.

Çdo vonesë në pagesën e kontributit shkakton pagesën e interesit të munguar nga Shqipëria mbi shumën e papaguar nga data e kërkueshme. Norma e interesit do të jetë norma e zbatuar nga Banka Qendrore Europiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, siç botohet në serinë C të Fletores Zyrtare të Bashkimit Europian që është në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajve në të cilat bie afati, rritur me 3.5 pikë përqindjeje. Në rast se vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që mund të rrezikojë ndjeshëm zbatimin dhe menaxhimin e Programit, dhe në mungesë të pagesës 20 ditë pune pas letres zyrtare të kujtesës të dërguar nga komisioni për Shqipërinë, pjesëmarrja e Shqipërisë në Programin për vitin përkatës do të pezullohet.

## SHTOJCA 2

### KONTROLI FINANCIAR, RIKUPERIMI DHE MASA TË TJERA KUNDËR MASHTRIMIT

I. Kontrollat dhe masat kundër mashtrimit nga ana e Bashkimit

1. Në pajtim me rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian dhe me rregullat e tjera të përmendura në këtë Memorandum Mirëkuptimi, kontratat e lidhura me përfituesit e programit të vendosur në Shqipëri parashikojnë auditime financiare ose auditime të tjera që do të kryhen në çdo kohë në ambientet e përfituesve dhe nënkontraktuesve të tyre nga agjentët e Komisionit ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni.

2. Agjentët e Komisionit dhe personat e tjera të autorizuar nga Komisioni do të kenë aksesin e nevojshëm në vendet, punët dhe dokumentet dhe të gjithë informacionin e kërkuar për kryerjen

e këtyre auditimeve, duke përfshirë formatin elektronik. Kjo e drejtë aksesit deklarohet shprehimisht në kontratat e lidhura për zbatimin e instrumenteve të përmendura në këtë Memorandum, Gjykata Europiane e Audituesve ka të njëjtat të drejta si Komisioni.

3. Në kuadër të këtij memorandumi, Komisioni/OLAF (Zyra Europiane kundër Mashtrimit) autorizohet të kryejë kontrole të menjëhershme në vend dhe inspektime në territorin shqiptar, në përputhje me dispozitat procedurale të Rregullores së Këshillit (Euratom, KE) nr. 2185/96, të datës 11 nëntor 1996.

Këto kontrole dhe inspektime përgatiten dhe kryhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente shqiptare, të cilat do të njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontroleve dhe inspektimeve, në mënyrë që ata të mund të ofrojnë të gjithë ndihmën e duhur.

Nëse autoritetet shqiptare të interesuara dëshirojnë, kontrollet e menjëhershme dhe inspektimet mund të kryhen së bashku me to.

Kur pjesëmarrësit në programe kundërshtojnë një kontroll të menjëhershëm ose inspektim, autoritetet shqiptare, duke vepruar në përputhje me rregullat kombëtare, u japin inspektorëve të Komisionit/OLAF-it ndihmën që ata kanë nevojë për t'i lejuar të përmbushin detyrën e tyre për kryerjen e një kontrolli ose inspektimi të menjëhershëm.

Komisioni/OLAF-i raporton sa më shpejt të jetë e mundur tek autoritetet shqiptare çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi që i është njoftuar gjatë kontrollit të menjëhershëm ose inspektimit. Në çdo rast, Komisioni/OLAF-i do t'i kërkojë të informojë autoritetin e lartpërmendur për rezultatin e këtyre kontroleve dhe inspektimeve.

#### II. Informimi dhe konsultimi

1. Për qëllimet e zbatimit të duhur të kësaj shtojce, autoritetet kompetente shqiptare dhe të BE-së do të shkëmbejnë rregullisht informacion dhe, me kërkesë të njëjës prej Palëve, do të zhvillojnë konsultime.

2. Autoritetet kompetente shqiptare do të informojnë Komisionin pa vonesë për çdo fakt ose dyshim që i është njoftuar mbi një parregullsi për lidhjen dhe zbatimin e kontratave të lidhura në zbatim të instrumenteve të përmendura në këtë Memorandum.



### III. Masat administrative dhe gjobat

Pa cenuar zbatimin e ligjit penal shqiptar, masat administrative dhe gjobat mund të vendosen nga Komisioni në pajtim me rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian.

### IV. Rikuperimi

Vendimet e marra nga Komisioni, brenda objektit të këtij Memorandumi, të cilat vendosin një detyrim monetar ndaj personave përveç shteteve, janë të ekzekutueshme në Shqipëri.

Ekzekutimi rregullohet nga rregullat e procedurës civile në fuqi në shtetin dhe territorin e të cilit është kryer. Urdhri për ekzekutimin i bashkëlidhet vendimit, pa formalitet tjetër përveç verifikimit të autenticitetit të vendimit, nga autoriteti i brendshëm që qeveria shqiptare cakton për këtë qëllim dhe ia njofton Komisionit.

Kur këto formalitete kanë përfunduar me kërkesë të Komisionit, ky i fundit mund të vazhdojë me ekzekutimin në pajtim me ligjin e brendshëm, duke e paraqitur çështjen drejtpërdrejt tek autoriteti kompetent. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian.

Vendimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian, në pajtim me një dispozitë arbitrazhi në një kontratë brenda objektit të këtij Memorandumi, janë të ekzekutueshme në të njëjtat kushte.

### **VENDIM Nr. 12/2017**

#### **PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REFORMËN ZGJEDHORE**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të nenit 24, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

#### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **VENDOSI:**

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore është një muaj nga data e miratimit të këtij vendimi.

### II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI  
Ilir Meta**

Miratuar në datën 9.2.2017

### **UDHËZIM Nr. 2, datë 8.2.2017**

#### **PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 11.8.2016, “PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT TË KANDIDATËVE NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, KANDIDATËVE ME ORGJINË SHQIPTARE NGA MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA, MEDVEGJA DHE BUJANOVCI, SI DHE KANDIDATËVE ME STATUSIN E TË VERBRIT, INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, TË JETIMIT, SI DHE ROMËT DHE EGJIPTIANËT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2016–2017”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 1.6.2016, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017”,

#### **UDHËZOJ:**

1. Në udhëzimin nr. 18, datë 11.8.2016, togfjalëshi “me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshojë në “*me statusin e personit me aftësi të kufizuar*”.

2. Pika 1.2.1 e kreut II, të ndryshojë në:  
“1.2.2 Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në



*pikën 1.2 duhet të dorëzojnë kopje të vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).”.*

3. Pika 1.2.2 e kreut II, shfuqizohet.

4. Ngarkohet, për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Lindita Nikolla**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë